



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“AUDITIM FINANCIAR (TEMATIK) NË BASHKINË MAT”



Tiranë, Shtator 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

NR	PËRMBAJTJA	FAQE
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-13
II	HYRJA	13-17
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	17-49
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	49-56
V	ANEKSE	57-62

SHKURTIME



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SHA	Shoqëri Anonime.
NjAB	Njësia e Auditit të Brendshëm

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.a. Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për krijimin e të ardhurave dhe përdorimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

shpenzimeve, vlerësimin e raportimit financiar, mbajtja e kontabilitetit dhe procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Mat dhe ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, aktrakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksionet financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur tre zonat e llogarive, të aktivitetit dhe pasivitetit të pozicionit financiar të pasqyruara në pasqyrat financiare.

I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Për vitin 2018 treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 85% ose nga 903,461 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 769,221 mijë lekë. Në zërin investime, buxheti është realizuar në masën 57% ose nga 145,946 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 83,853 mijë lekë. Të ardhurat e veta, për vitin 2018 janë realizuar në masën 64% ose nga 92,990 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 59,879 mijë lekë. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve, Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë Investimet në masën 57% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë nuk janë kryer likuidimet brenda vitit.</p> <p>Buxheti për vitin 2018 është miratuar me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mat me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti me shkresën nr.778/1 prot date 23.05.2018. <i>Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2018 është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</i> Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</p>	17-49	I LARTË	Nga Bashkia Mat, të merren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe brenda afateve ligjore, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.
2	Bazuar në të dhënat e Buxhetit dhe të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në	17-49	I LARTË	Bashkia Mat, Sektori i Financës, bazuar në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 73,014,051 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 14,904,892 lekë, për 8 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 42,065,693 lekë, për 110 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 16,043,466 lekë, në 3 raste.</p> <p>Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none">-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 ⁽¹⁾-E drejta për të kryer shpenzime,-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”			<p>Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 73,014,051 lekë, sipas Aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 31.12.2018, e rakorduar kjo me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e financave.</p>
3	<p>Programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për vitin 2018, është miratuar në vlerën 92,990 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 59,879 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 33,111 mijë lekë, ose 64,3%.</p> <p>Detyrimet debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2018 janë në vlerën 23,410,462 mijë lekë nga 617 subjekte, nga të cilët 520 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 12,098 mijë lekë dhe 97 subjekte të biznesit të madh në vlerën 11,312 mijë lekë.</p> <p>Detyrimet debitorë për taksat dhe tarifave familjare si dhe për taksën e tokës bujqësore janë në vlerën 19,932 mijë lekë për 9540 familje.</p> <p>Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018.</p> <p>Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ultë për vitin 2018, ku ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e cila është</p>	17-49	I LARTË	<p>Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mat, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:</p> <ul style="list-style-type: none">-për 617 subjekte të biznesit të madh e të vogël, debitorë në vlerën 23,410,462 lekë dhe për 670 familje debitorë për

¹⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>programuar në masën 12,000 mijë lekë, realizuar në masën 7,228 mijë lekë ose 58% si dhe mos realizimi i të ardhurave nga tarifat lokale, si tarifa e shërbimit e cila është programuar në masën 15,000 mijë lekë, realizuar në masën 13,321 mijë lekë ose 88,8%.</p> <p>*Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore e bashkisë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura, të taksave dhe tarifave vendore, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese si <u>bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008</u>” Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar</p>			<p>taksa e tarifat familjare dhe taksën e tokës bujqësore, në vlerën 19,932,000 lekë. Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p>a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p>b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p>c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p>d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.</p>
4	<p>Gjendja e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm” e cila rezulton në fund të vitit 2018 në vlerën 47,702,992 lekë, e cila përbëhet nga debitorët e biznesit të vogël dhe debitorët e biznesit të madh dhe vip, në vlerën 40,856,648 lekë dhe gjoba dhe detyrime të lëna nga kontrollet e viteve të mëparshme nga auditi i KLSH-së dhe i Prefekturës, për 7 NJA, në vlerën 6,846,344 lekë. Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për</p>	17-49	ILARTË	<p>Bashkia Mat, Sektori i Financës, dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për sistemimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	detyrimet familjare, sipas regjistrave të zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore. Kontabiliteti i detyrimeve për taksat dhe tarifave Vendore ndiqet nga Sektori i Taksave Tarifave Vendore. Vlera e pasqyruar në kontabilitet për debitorët e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë të përfshirë detyrimet familjare për taksat dhe tarifave vendore familjare. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018. Në këto kushte, pasqyrat financiare nuk janë reale pasi llogaritë debitore për shumën e detyrimeve Tatim Taksat Lokale, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për vlerën 19,932 mijë lekë, detyrime për taksat familjare për 9540 familje. Mos evidentimi i vlerës së debitorëve familjarë, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.			të ndryshëm” ku të evidentojnë vlerën 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore.
5	<p>Gjendja e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 26,701,445 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studim projekteve për investime në vite. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:</p> <p>...në 31 raste janë studime e kërkime në vlerën 10,474,397 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara ish Bashkia Burrel dhe nga 7 ish Komunitat të cilat janë përthithur nga Bashkia Mat.</p> <p>...në 13 raste janë studime e kërkime në vlerën 16,167,048 lekë i përkasin investimeve për objekte të pafinancuara në vitet e kaluar e në vijim të Bashkisë Mat dhe konkretisht në NjA Komsu janë objekte të pa financuara në vlerën 493,680 lekë, në NjA Lis janë objekte të pa financuara në vlerën 814,400 lekë, në NjA Burrel 14,761,048 lekë, në Bordin e Kullimit në vlerën 97,920 lekë dhe në Njësinë Administrative Baz,</p> <p>...në 2 raste janë studime e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në në aktiv të pasqyrave financiare.</p> <p>Si përfundim konstatohet se:</p> <p>.....për 31 rastet e studimeve e kërkimeve në vlerën 10,474,398 lekë, duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.</p> <p>.....për 2 rastet e studimeve e kërkimeve në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në në aktiv të pasqyrave financiare.</p> <p>Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.</p>	17-49	ILARTË	Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar dhe ato të pa financuara. Për vlerën 10,474,398 lekë , llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duhet të pakësohet dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet, të sistemohet vlera 60,000 lekë në llogaritë e klasës 6.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
6	<p>Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 26,247,728 lekë, ndërsa në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 27,362,728 lekë, vlerë e cila përbëhet nga vlera e objekteve si: Lulishte në shkolla Nj A Macukull, Tokë për varreza, terrene sportive dhe kënde të lojërave në ish Bashkinë Burrel etj. Shtesa prej 1,115,000 lekë përbën shpronësim toke për varreza në fshatin Mallunxë. Nga analiza e mëtejshme e kësaj llogarie konstatohet se:</p> <p>-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” si Godina e Bashkisë, Ndërtesat si: Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare; Ndërtesat e ish Ndërmarrjes Pyjore, Ndërtesat e ish Komunave sot Njësi Administrative.</p> <p>-Në këtë llogari nuk është pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat.</p> <p>-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Mos evidentimi i vlerës së trojeve të objekteve dhe vlerës së trojeve të lira dhe të objekteve sipas VKM-ve, dhe mos kryerja e inventarizimit dhe vlerësimit të trojeve dhe terreneve, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.</p>	17-49	ILARTË	<p>Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë si dhe të kryhet inventarizimi i trojeve me komision.</p>
7	<p>Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 10,550,203 lekë. Në këtë llogari janë të përfshira Pyllëzime me arrorë Nj A Macukull, Pyje e kullota Nj A Rukaj, sistemime dhe gjelbërimi në Nj A Baz dhe Ndërmarrja e Shërbimeve. Nga analiza e mëtejshme e kësaj llogarie konstatohet se:</p> <p>-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.</p> <p>-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Mat, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 10, shtojca me nr.8, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Mat, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy). Mos evidentimi i vlerës së pyjeve dhe kullotave dhe mos kryerja e inventarizimit dhe vlerësimit të pyjeve dhe kullotave, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.</p>	17-49	ILARTË	<p>Bashkia Mat, Sektori i Financës, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin dhe evidentimin e pronave në llogarinë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në pasqyrat financiare, të cilat janë në pronësi të Bashkisë..</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
8	<p>Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në pasiv të bilancit në vlerën 16,141,000 lekë e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme, për garanci punimesh të përcaktuara në kontratat e lidhur midis palëve, gjendje më 31.12.2018. Nga analiza e kësaj llogarie, rezulton se vlera 16,141,000 lekë përbëhet si vijon:</p> <p>.....vlera 10,916,020 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018,</p> <p>....vlera 5,224,980 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera gjatë vitit 2018, të cilat janë brenda afatit të garancisë të përcaktuar në kontratë.</p> <p>konstatohet se:</p> <p>.....vlera 10,916,020 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018, të cilat ju ka përfunduar afati i caktuar në kontratë. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar prej 10,916,020 lekë. Mos sistemimi i vlerës së garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e pasiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.</p>	17-49	ILARTË	<p>Bashkia Mat, Sektori i Financës, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për sistemimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,916,020 lekë ku të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin nr.2 bashkangjitur</p>
9	<p>Nga Sektori i Financës, Bashkia Mat, nuk janë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për vitin ushtrimor 2018, ku përveç pasqyrave financiare të njësive Bashkia Mat të përfshiheshin edhe pasqyrat financiare të 3 (tre) njësi vartëse e përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjellësit sha. Hartimi i informacionit kontabël të konsoliduar në njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështetet në parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit dhe të përgatitjes e paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore individuale të njësive, për nivelet përkatëse të qeverisjes në të cilat bëhet konsolidimi i informacionit. Ky konsolidim është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të prodhohet një informacion i dobishëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm, në shërbim të vendimmarrjeve të qeverisjes së përgjithshme, në nivele qendrore dhe lokale. Nisur nga fakti se Pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara kanë si qëllim të përgjithshëm dhënien e informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, nëpërmjet: Sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre; Sigurimit të informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësive dhe realizimin e kërkesave mbi mjetet monetare; Sigurimit të informacionit që lidhet me aftësinë e njësive për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet; si dhe Sigurimit të informacionit për vlerësimin e performancës së njësive raportuese.</p>	17-49	ILARTË	<p>Bashkia Mat, Sektori i Financës, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për të hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për të Bashkisë në vitet në vijim ku të evidentohen edhe pasqyrat financiare të 3 (tre) njësi vartëse e përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjellësit sha.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	Mos hartimi i pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara nuk mundëson grupimin e informacioni, duke bërë eliminimet dhe duke mënjanuar dublimet, për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë; Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” pika 98, 99,100,101 germa “b”.			
10	Në realizimin e të ardhurave nga tarifat e Drejtorisë së shërbimeve bashkiake, sektori i infrastrukturës, Bashkia Mat, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën 5,000,000 lekë , sipas aneksit nr.1, bashkangjitur, për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë. Gjithashtu nuk janë pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, të trajtuara në aneksin nr.B/4. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9 dhe të VKB nr.69, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”.	17-49	I LARTË	Nga Bashkia Mat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e detyrime të pa arkëtuara nga licencat e subjekteve të tregtimit të karburanteve në vlerën 5,000,000 lekë , me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Mat, sipas aneksit nr.1, bashkangjitur.
11	Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Dibër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Mat, konstatohet se deri më 31.12.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 83 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 22325,84 m ² , jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe -VKB nr.33, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër, sipas aneksit nr.2 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,853,017 lekë .	17-49	I LARTË	Nga Bashkia Mat, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me ALUIZNI dhe ZVRPP Mat të merren masa për zgjidhjen e situatës të krijuar duke ndjekur procedurat administrative-ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit në vlerën 2,853,017 lekë , sipas aneksit nr.2 bashkangjitur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportit Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi

I.c. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700 shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Mat duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Mat, të vitit ushtrimor 2018, vlerat e paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Formatit nr.2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Formatit nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash flow), Formatit nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formatit nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e raportimi pasqyrave financiare vjetore), Formatit nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formatit nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formatit nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formatit nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% (vlerën 8,064 mijë lekë për të ardhurat) për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Përshkrimi i çështjeve:

-Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore,

-Në llogarinë 202 “Aktive Afatgjata jo materiale”, nuk është sistemuar vlera prej 10,474,398 lekë që i përkasin 31 raste studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2018, për objekte të përfunduara në vitet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

kaluara dhe për 2 rastet e studimeve e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në aktiv të pasqyrave financiare.

-Në llogarinë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave si Godina e Bashkisë, Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare, Ndërtesat e ish Ndërmarrjes Pyjore, Ndërtesat e ish Komunave sot NjA dhe vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat, *nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve.*

-Në llogarinë 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Mat, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, pika 10, shtojca me nr.8, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy), nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në llogarinë nr.466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, nuk është sistemuar vlera prej 10,916,020 lekë, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të bizneseve.

-Në Bashkinë Mat, Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizojnë referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm;

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mat

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 556/1, datë 13.08.2019, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 15.08.2019 deri më datë 06.09.2019, në subjektin Bashkia Mat për periudhën nga 01.01 - 31.12.2018, u krye auditimi “Auditim financiar (tematik) për pasqyrat financiare 2018” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1. H. A., Përgjegjës Grupi**
- 2. L. B., Auditues**

Titulli: Auditim financiar (tematik) në Bashkinë Mat.

Marrësi: Bashkia Mat.

Objektivat dhe qëllimi: Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Mat për vitin 2018. Auditimi u shtri në vlerësimin e pozicionit financiar të llogarive të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2018 të Bashkisë Mat.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është: Të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 1320), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Auditimi promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.

Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, hartimin e zbatimit e buxhetit.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Mat.

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mat janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë Mat, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e auditimit.

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

- Standarde Ndërkombëtare Auditimit (ISA), Federata Ndërkombëtare Kontabilistëve IFAC,
- Manuali Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI¹, INTOSAI “Për implementimi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,
- Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),
- Në praktikat më të mira të fushës,
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.
- UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”,

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:

Administratori i Përgjithshëm (*Nëpunësi autorizues*) z. N. R.- ish Kryetar i Bashkisë Mat dhe (Nëpunësi zbatues) znj. D. K. - ish Përgjegjëse e Financës, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori i përgjithshëm dhe Përgjegjësi i Financës, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Mat.

Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku thuhet se: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
- ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65 “Administrata e njësisë administrative”, pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Mat dhe një opinion në lidhje me aktivitetin e subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë,
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre,
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar,

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme,

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël,

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura,

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion,

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC,

-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Në praktikat më të mira të fushës,

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

-Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

-Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, për vitin 2018 vlerën 8,064 mijë lekë për të ardhurat dhe vlera 9,950 mijë lekë për shpenzimet dhe për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik. Nisur nga fakti se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët, Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm:

Aktiviteti i Bashkisë Mat.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është këshilli bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

Sa më sipër organizimi dhe funksionet në NJQVV, burojnë nga kërkesat e ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

A.Planifikimi dhe identifikimi riskut; Strategjia dhe vlerësimi i riskut; Ekzekutimi i procedurave të testimit; Përgatitja e dokumenteve standarde të auditimit dhe komunikimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme me subjektin e audituar.

Në auditimin e kryer për planifikimin dhe identifikimin e riskut, strategjia dhe vlerësimi i tij, konstatohet se sipas auditimit të mëparshëm dhe rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.1434/6, datë 22.08.2019 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet”, në drejtim të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh, nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut, nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i tyre. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës, por në të nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen deri në një farë mase. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njesisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi:

-Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.

-Në lidhje me menaxhimin e riskut: Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21.

-Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njesisë

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm, në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun në fushat e auditimit që janë me risk më të lartë si fusha e prokurimeve, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, e planifikim-zhvillimit të territorit dhe e administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë për të cilat nuk janë zhvilluar auditime të thelluara. Gjithashtu nuk ka nxjerrje përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nga Bashkia, janë dërguar në Ministrinë e Financave deklarata, pyetëtori dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Karta e Auditimit të NJAB nuk është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Mat, në kundërshtim me nenin nr. 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, si dhe në kundërshtim me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2017-2019, por ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6

Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2018 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.2.

Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2018, dhe pasqyrat shoqëruese, janë dërguar në afat, por pjesa përshkruese e raportit nuk është përgatitur sipas standardeve që përcakton MAB, Kapitulli III, pika 3.6

Struktura e projektraportit dhe e raportit përfundimtar të auditimit nuk është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017“Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet.

1.Programimi i PBA 2018-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018;

Buxheti i vitit 2018 është hartuar kryesisht mbi bazën e 10 programeve të cilat janë:

Programi i administratës vendore Programi i kujdesit social për familje dhe fëmijë Programi i menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve publike Program arsimi, parauniversitar dhe edukimit Programi i arsimit,parashkollor+bazë	Programi mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave Programi i administrimit të pyjeve Program infrastrukturës, kullimit, ujitjes Programi i transportit rrugor (rrugët rurale) Programi i strehimit dhe urbanistikës
---	--

Në lidhje me programimin e buxhetit për periudhën e viteve 2018, sipas dokumenteve të vëna në dispozicion konstatohet se, për vitin 2018 buxheti i Bashkisë Mat është miratuar me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mat me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti i me shkresën nr.778/1 prot datë 23.05.2018.

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2018 është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2018 krahasuar me planin e PBA.

në 000 lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i buxhetit 2018	Plani i vitit 2018 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600,601)	271423	234550	36.873
2	Shpenzime korrente (602,604,609)	486093	410420	75.673
3	Shpenzime investimi (230/231)	145945	40819	105.126
Totali:		903.461	685789	217.672

Nga krahasimi i planit të buxhetit 2018 me planin e vitit 2018 në PBA rezulton një diferencë e konsiderueshme prej 217,672 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se:

Në buxhetin e vitit 2018 bëjnë pjesë të ardhurat dhe shpenzimet e trashëguara nga viti i kaluar të cilat në hartimin e PBA-së nuk planifikohen sidomos mbetja e investimeve të pa realizuara në fund të vitit 2017 përfshirë në buxhetin e vitit 2018.

Shtesa e grantit të pakushtëzuar për vitin 2018 është jashtë parashikimit në planin e vitit 2018 në PBA.

Grupi i punës për menaxhimin strategjik (GMS), ngritur nga Kryetari i Bashkisë, ka hartuar PBA për periudhën 2018-2020 dhe është raportuar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 2000, datë 09.08.2017. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë dhe institucionet vartëse, drejtoritë e shkollave, drejtoritë e bashkisë, njësitë administrative, etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Për hartimin e buxhetit të vitit 2018 është ngritur grup pune nga titullari me Urdhrin nr.151 datë 14.04.2017. Ky dokument është hartuar nga Sektori Financës dhe Buxhetit.

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitit 2018 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë. Për vitin 2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se programimi i plan buxhetit i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2018 është në vlerën 497,478 mijë lekë.

Programimi i buxhetit për vitin 2018.		Në 000/lekë	
Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2018	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Te ardhura te trashëguara viti 2017	93.587	
2	Transferta e pakushtëzuar viti 2018	178.112	
3	Transferta e specifikë viti 2017./18	139.789	
4	Plani i të ardhurave viti 2018	85.990	
1	Paga (600)		225.309
2	Sig.shoqërore (601)		37.360
3	Shpenzime operative (602)		130.247
4	Transferta (603+604+605+606+609)		15.866
5	Investime (230 +231) nga buxheti Bashkisë		89.696
Totali i buxhetit		497.478	497.478

Sipas pasqyrës më sipër rezulton se për vitin 2018 buxheti është miratuar i balancuar dhe pa deficite, është miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe konfirmuar nga prefektura e Qarkut Dibër, përkatësisht me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mat me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti i me shkresën nr.778/1 prot datë 23.05.2018. “Miratim shtesë në buxhetin e vitit 2018 nga transfertat dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2017”, Gjatë vitit, buxhetit i janë bërë ndryshime sipas miratimit me VKB nr.104, datë 19.11.2018 “Miratim ndryshim në buxhetin e vitit 2018 “konfirmuar nge prefekti i Qarkut Dibër me shkresën 1875/1 prot datë 04.12.2018. Në total buxheti për Bashkinë Mat është programuar në shumën 497,478 mijë lekë, nga të cilat 100,940 mijë lekë janë me burim financimi nga të ardhurat e veta, 396.538 mijë lekë me burim financimi të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifikë.

Realizimi i treguesve të buxhetit, sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit, fonde vetëm të Bashkisë ku nuk janë përfshirë, fonde të deleguara dhe FZHR.

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet në 000 lekë

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	viti 2018		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	225,309	208,655	92,6
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	37,360	35,528	95
3	602 Shpenzime operative	130,247	75,416	57,9
5	604 K.Qarkut+ emergj.civile + transfertat	14,956	14,956	100
6	606 Nd.ekonomike+shpërblim lindje			
7	609 Fondi rezervë dhe kontigjenca,emergjence civile	910		
8	231 Investime objekte	89,696	83,359	92,9
	TOTALI	497,478	417,914	84

2.Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i planifikuar vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, për vitin 2018 është 903,461 mijë lekë si në vijim:

Pasqyra e planit përfundimtar të buxhetit për 2018. në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani përfundimtar i vitit 2018
1	Paga 600	214.41
2	Sigurime shoqërore 601	37.01
3	Shpenz.operative 602	119.19
5	K.Qarkut Emergj.civile 604	76.10
6	Nd ekonomike invalid 606	287.77
7	Sherbimi borxhit, principal 166	
8	Sherbimi borxhit, interesa 651	
9	Fond rezerve dhe kontigjense 609	91
10	Investime 231	145.94
Total buxheti me ndryshime		903,46

Si rezultat i ndryshimeve gjatë vitit brenda zërave të shpenzimeve janë bërë ndryshimet e nevojshme të cilat janë miratuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Për vitin 2018 janë bërë ndryshime e konkretisht, një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36, datë 18.05.2018, konfirmimi nga Prefekti me shkresën nr.778/1, datë 23.05.2018. “Miratim shtesë në buxhetin e vitit 2018 nga transfertat dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2017”, për shumën 93,587 mijë lekë dhe me VKB nr.104, datë 19.11.2018 “Miratim ndryshim në buxhetin e vitit 2018 “konfirmuar nga prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.1875/1, datë 04.12.2018, në vlerën 2,000 mijë lekë. Ndryshimet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme në vlerën totale për secilën llogari.

Pasqyra e ndryshimeve të buxhetit si shtesa dhe paksimet për vitet 2018. në 000/lekë

Nr.	Emertimi	Viti 2018	
		Shtesa	Pakësime
1	Paga (600)	15.58	
2	Sigurime shoqërore (601)	3.16	
4	Shpenzime te tjera(604,609)	20.27	2.000
5	Investimet (231,230)	56.55	
Totali		95.58	2,00

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:

Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve. Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar. Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme. Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël dhe janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

3.Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2018 shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 903,463 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 766,221 mijë lekë ose në masën 85%. Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit Mat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Mat duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës në vijim përfshirë edhe fondet e deleguara si dhe të ardhura nga FZHR:

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitet 2018. Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2018		
		Plan	Fakt	Realizimi %
1	Paga 600	231,69	208,65	9
2	Sigurime shoqërore 601	39,73	35,52	89,
3	Shpenz.operative 602	121,30	75,41	62,
4	K.Qarkut Emergj.civile 604	76,10	76,10	10
5	Nd ekonomike invalid 606	287,77	287,16	99,
6	Fond rezerve dhe kontigjense 609	91		
7	Investime 231	145,94	83,35	24,
Total buxheti me ndryshime		903,46	769,22	8

Analizë për investimet

Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Mat u konstatua se për vitin 2018, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR, janë planifikuar investime në vlerën 145,945 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 83,854 mijë lekë sipas pasqyrës bashkangjitur RPA..

Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, pasi janë bazuar në prioritetet e caktuara, në kërkesat e paraqitura dhe verifikimit në vend të problemit, duke zhvilluar takime me komunitetin me qëllim nxjerrjen e nevojave reale dhe evidentimin e atyre me imediate. Për investimet e papërfunduar nga viti paraardhës, ka patur prioritet i pari për tu financuar në vitin ushtrimor. Bashkia Mat me transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e saj nuk e ka të mundur realizimin e shume investimeve por është përqendruar tek ato me të domosdoshme për komunitetin. Është respektuar radha e financimit sipas ligjit, nuk janë krijuar detyrime të reja me përjashtim të disa vendime gjyqate të cilat janë mbartur nga ish Komunat dhe ish Bashkia Burrel. Nuk janë shlyer në kohë të gjitha detyrimet kontraktuale sidomos disa fatura të parashikuara nga të ardhurat e Bashkisë si dhe rastet e vënies së limitit të cash-it nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

Limiti i vënë nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka ndikuar negativisht në realizimin e shpenzimeve sipas planifikimit, pasi ka pasur fonde për likuidim dhe faturat kanë mbetur të palikuiduara duke shtuar vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc ku për vitin 2018 vlera totale e detyrimeve është 73,014,051 lekë, përfshirë faturat e muajit dhjetor 2018.

Nga Bashkia Mat është marrë çdo masë e nevojshme për miratimin në kohë të buxhetit të vitit 2018, pavarësisht faktit që shkresa e detajimit të transfertës së pakushtëzuar dhe asaj specifike ka ardhur në fund të muajit dhjetor duke krijuar mjaft vështirësi, megjithatë buxheti është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

miratuar për vitin 2018 me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti me shkresën nr.778/1, date 23.05.2018.

Në çdo rast janë ndjekur hapat për realizimit e pagesave të shpenzimeve, duke nxjerrë urdhrin e prokurimit për çdo rast dhe është konfirmuar në Degën e Thesarit, është zhvilluar procedura e prokurimit, është lidhur kontrata, pune apo shërbime, janë marrë në dorëzim në çdo rast nga grupi i kolaudimit i ngritur për këtë qëllim, ndërsa për investimet grupi i ngritur nga Zyra e Urbanistikës. Në çdo procedure prokurimi janë dokumentet nga urdhri i prokurimit, kontrata, fatura tatimore, situacioni në rastet e punëve apo shërbimeve, fletë hyrja e magazinës etj.

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe kanë vulën dhe datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit. Nuk u konstatua asnjë rast mos regjistrimi të urdhrin të prokurimit në Degën e Thesarit.

Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën e Thesarit dhe të shtrira në kohë sipas financimit. Në të gjitha rastet e regjistrimit të kontratave fondet kanë qenë disponibël. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj dhe në rastet kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Janë depozituar për regjistrim në Degën e Thesarit, brenda afatit 30-ditor të gjitha urdhër shpenzimet, duke përjashtuar rastet kur ka pasur limit të vendosur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr. 19932 datë 07.11.2018 në shumën lekë 12,025 mijë lekë.

Nga Kryetari i Bashkisë janë përgatitur raporte 4-mujore për të ardhurat dhe shpenzimet dhe është raportuar në Këshillin e Bashkisë për këto probleme, nuk është raportuar për çdo muaj, veprime në kundërshtim me nenin 44, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

4.Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor; Niveli arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV, apo organeve të tjera;

Trajtuar me Akt konstatimi, të veçantë.

Në auditimin e kryer për programimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, bazuar në dokumentet e paraqitura dhe të dhënat e Sektorit të Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore, u audituan dokumentacioni si, Evidencat analitike të llogarive debitore për tatim taksat lokale, Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore. Evidencat mbi gjendjen e debitorëve për tatim taksat lokale për subjektet dhe për detyrimet familjare, të tjera dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale dhe Vendimet e Këshillit të Bashkisë për strukturën organike, ku u konstatua se:

Programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për vitin 2018, është miratuar në vlerën 92,990 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 59,879 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 33,111 mijë lekë, ose 64,3%, sipas aneksit bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Detyrimet debitore të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2018 janë në vlerën 23,410,462 mijë lekë nga 617 subjekte, nga të cilët 520 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 12,098 mijë lekë dhe 97 subjekte të biznesit të madh në vlerën 11,312 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Detyrimet debitore për taksat dhe tarifat familjare si dhe për taksën e tokës bujqësore janë në vlerën 19,932 mijë lekë për 9540 familje.

Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ultë për vitin 2018, ku ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e cila është programuar në masën 12,000 mijë lekë, realizuar në masën 7,228 mijë lekë ose 58% si dhe mos realizimi i të ardhurave nga tarifat lokale, si tarifa e shërbimit e cila është programuar në masën 15,000 mijë lekë, realizuar në masën 13,321 mijë lekë ose 88,8%

Në vijim po paraqesim në formë tabele evidencën e gjendjes së numrit të bizneseve dhe ndryshimet gjatë periudhës së vitit 2018.

Evidenca e gjendjes së numrit të Bizneseve për periudhën 01.01.2018- 31.12.2018

EMËRTIMI	Gjendja ne fillim	Regjistrime te reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund te vitit
Totali i bizneseve	565	67	15	617

Sa më sipër konstatohet se numri i bizneseve në total është në rritje, regjistrimet e reja të bizneseve janë 67, bizneset që kanë mbyllur aktivitetin janë 15 dhe gjendja në fund të vitit rezultojnë 617 biznese.

Krijimi i regjistrit të tatim paguesve në mënyrë manuale dhe elektronike. Kontrollat e bëra për grumbullimin e taksave, rakordimi me agjentët tatimorë, problemet e dala dhe masat e marra; Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore janë hapur regjistrat në mënyrë manuale dhe elektronike ku janë regjistruar të gjithë tatim paguesit që kanë detyrimin për pagimin e taksave dhe tarifave vendore. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga personeli i Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë, u audituan dosjet e subjekte me aktivitet të ndryshme, të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për përcaktimin dhe llogaritjen detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore si për tarifën e pastrimit urban, për tarifën e ndriçimit, për tarifën e gjelbërimit, për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi, për taksën mbi ndërtesën dhe nuk u konstatuan probleme.

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve sipas Njësive Administrative **u konstatua se:**

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore u është dërguar shkresë për secilin subjekt që kanë sipas ndarjes administrative territoriale, ku është përcaktuar detyrimi për çdo taksë apo tarifë vendore që tatim paguesi detyrohet për të paguar për llogari të bashkisë. Kjo praktikë është zbatuar dhe është në praktikën e punës së çdo inspektori që në fillim të çdo viti të njoftojë të gjithë subjektet taksa pagues për llojet e detyrimeve dhe afatin ose kohën e pagesës që duhet të kryej në bankat e nivelit të dytë. Nga administrata tatimore e bashkisë dhe e Njësive Administrative janë plotësuar njoftimet e detyrimit dhe u janë dërguar në rrugë postare subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat por nuk janë arkëtuar plotësisht detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues. Veprimi dhe mosveprimi është në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 23 Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin, pika 2.

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkisë dhe Njësitë Administrative, është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, është bërë përditësimi të dhënave dhe është plotësuar dokumentacioni, ku janë regjistruar të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprimi dhe mosveprimi është në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1.

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkisë dhe e Njësive Administrative, është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:

-të gjitha praktikrat shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë.

-praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit.

Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” neni 24, ku përcaktohet: *Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë : a) të evidencojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë, c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d" të këtij ligj, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave “Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21 dhe neni 27.*

Gjendja e debitorëve për taksat vendore, në numër dhe vlerës, sipas bizneseve, taksës tokës, taksat e popullatës, etj.

Nga auditimi i të dhënave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se gjendja e debitorëve në fillim dhe në fund të vitit 2018, paraqitet sipas pasqyrës si vijon:

Pasqyra e gjendjes së debitorëve në fillim dhe në fund të vitit 2018. Në / lekë.

EMËRTIMI	01.01.2018		31.12.2018	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Biznesi i Vogël	47	10,234,77	28	12,390,88
Biznesi i Madh	8	9,891,44	56	11,355,57
TOTALI	56	20,126,21	34	23,746,45

Lista analitike e debitorëve të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh, për periudhën e viteve 2017 dhe vitin 2018, nuk u printua nga ana e grupit të auditivit, por janë mbajtur në format excel, nga zyra e taksave dhe tarifave vendore.

Sipas Njësive Administrative debitorët paraqiten në vijim:

Emertimi	Njësia administrative	Nr i subjekteve debitor	Vlera ne leke
Biznesi i madh	Burrel	25	6,495,31
	Komsi	11	1,575,43
	Lis	12	1,808,51
	Macukull	1	35,00
	Ulez	5	1,266,07
	Derjan	1	131,57
	Rukaj	1	43,65
	Baz	0	
Totali		56	11,355,57



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Biznesi i vogel	Burrel	193	10,008,34
	Komsi	25	780,58
	Lis	19	406,94
	Macukull	20	331,21
	Ulez	8	381,83
	Derjan	4	102,28
	Rukaj	10	231,92
	Baz	6	76,75
Totali		285	12,390,88

Taksat dhe Tarifat familjare janë miratuar për vitin 2018, me VKB nr.69, datë 27.12.2017, përkatësisht është miratuar taksë ndërtese për familjarët 5 lekë m² në vit për çdo familje deri me 31.03.2018 dhe me 01.04.2018 ka patur ndryshim të kësaj takse bazuar në VKM nr. 132, datë 7.3.2018 është miratuar 16 lek m², është miratuar Tarifë shërbimi për familjarët 1,500 lekë në vit për çdo familje, ndriçimi 100 lekë për çdo familje.

Për vitin 2018, janë planifikuar 22,981 mijë lekë dhe janë realizuar 3,048 mijë lekë, ose 13 % e planit vjetor. Nga verifikimi rezulton se janë planifikuar të ardhura për 10967 mije familje për vitin 2018 sipas regjistrimit të gjendjes civile më datë 01.01.2018. Sipas NjA rezultojnë në Njësinë administrative Burrel 5055 familje, në Njësinë Administrative Baz 1858 familje, në Njësinë Administrative Komsi 1333 familje, Njësinë Administrative Lis 1266 familje, në Njësinë Administrative Rukaj 936 familje, në Njësinë Administrative Ulez 556 familje, në Njësinë Administrative Derjan dhe Macukell 953 familje.

Në planifikim nuk janë planifikuar saktë të ardhurat për vitin 2018, pasi nuk janë marrë në konsideratë vlera debitore e trashëguar në vite për taksat dhe tarifatat familjare.

Sipërfaqja e tokës së ndarë për Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative është si në vijim:

Pasqyra e ndarjes së tokës bujqësore sipas familjeve, bashkia Mat.

Nr.	Zonat	Sipërfaqja në Ha	Nr.familjeve
1.	Burrel		505
2.	Ulez	26	55
3.	Baz	65	185
4.	Komsi	96	133
5.	Lis	1,13	126
6.	Macukell	34	95
7.	Derjan	46	
8.	Rukaj	88	93
	Gjithsej	4,71	1195

Nga krahasimi i vlerës së debitorëve në pasqyrat financiare të pasqyruara në *llogarinë 468* “Debitor të ndryshëm” e cila rezulton në fund të vitit 2018 në vlerën 47,702,992 lekë, dhe përbëhet nga debitorët e biznesit të vogël dhe debitorët e biznesit të madh dhe vip, në vlerën 40,856,648 lekë dhe gjopa dhe detyrime të lëna nga kontrollet e viteve të mëparshme nga auditimi i KLSH-së dhe i Prefekturës, për 7(shtatë) NJA, në vlerën 6,846,344 lekë.

-Në këtë llogari nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore. Kontabiliteti i detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, ndiqet nga Sektori i Tatim Taksave Vendore. Vlera e pasqyruar në kontabilitet për debitorët e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë të përfshirë detyrimet familjare për taksat dhe tarifatat vendore familjare. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018. Nga mos dorzimi i listave të debitorëve familjar, pasqyrat financiare nuk janë reale pasi llogaritë debitore për shumën e detyrimeve të Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për vlerën 19,932 mijë lekë, detyrime për taksat familjare për 9540 familje. Mos evidentimi i vlerës së debitorëve familjarë, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35; Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjstëve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Zbatimin e procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksave e tarifave vendore dhe llogaritja e kamat vonesave, në zbatim të neneve 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Sipas dokumenteve të paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se detyrimet progresive për tatim taksat lokale deri më datën 31.12.2018, sipas subjekteve, është në shumën totale për 13,299 mijë lekë, nga 109 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël, deri më datën 31.12.2018, sipas të dhënave që na u paraqitën, është në shumën totale për 22,528 mijë lekë, nga 118 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël, e detajuar jepet sipas të dhënave të pasqyrës që vijon në 000/lekë:

Pasqyra e gjendjes së debitorëve në fillim dhe në fund të vitit 2018. Në / lekë.

EMËRTIMI	01.01.2018		31.12.2018	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Biznesi Vogël	47	10,234,77	28	12,390,88
Biznes i Madh	8	9,891,44	56	11,355,57
TOTALI	56	20,126,21	34	23,746,45

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, nga bizneset, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit. Detyrimet debitore për taksat dhe tarifave familjare si dhe për taksën e tokës bujqësore janë në vlerën 19,932 mijë lekë për 9540 familje.

Për arkëtimin e detyrimeve debitore, nuk është vazhduar procedura për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore në R.SH” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

*Programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për vitin 2018, është miratuar në vlerën 92,990 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 59,879 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 33,111 mijë lekë, ose 64,3%.

Detyrimet debitore të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2018 janë në vlerën 23,410,462 mijë lekë nga 617 subjekte, nga të cilët 520 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 12,098 mijë lekë dhe 97 subjekte të biznesit të madh në vlerën 11,312 mijë lekë.

Detyrimet debitore për taksat dhe tarifave familjare si dhe për taksën e tokës bujqësore janë në vlerën 19,932 mijë lekë për 9540 familje.

Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ultë për vitin 2018, ku ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e cila është programuar në masën 12,000 mijë lekë, realizuar në masën 7,228 mijë lekë ose 58% si dhe mos realizimi i të ardhurave nga tarifatat lokale, si tarifa e shërbimit e cila është programuar në masën 15,000 mijë lekë, realizuar në masën 13,321 mijë lekë ose 88,8%.

*Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore e bashkisë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura, të taksave dhe tarifave vendore, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar.

*Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezulton se nga Sektori i Tatim Taksave për abonentët familjarë ka regjistra të përditësuara, për evidentimin e vlerës së detyrimit që ato kanë dhe vlerën e detyrimit të mbetur; është plotësuar dhe dërgohej tek abonentët familjarë njoftim detyrimi për taksat e tarifatat vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, vlerën e paguar dhe vlerën e mbetur.

Nga krahasimi i vlerës së debitorëve në pasqyrat financiare të pasqyruara në *llogarinë 468* “Debitor të ndryshëm” konstatohet se në këtë llogari nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore. Vlera e pasqyruar në kontabilitet për debitorët e Tatim Taksat Lokale, nuk janë të përfshirë detyrimet familjare për taksat dhe tarifatat vendore familjare. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018. Nga mos dorëzimi i listave të debitorëve familjar, pasqyrat financiare nuk janë reale pasi llogaritë debitorë për shumën e detyrimeve Tatim Taksat Lokale, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për vlerën 19,932 mijë lekë, detyrime për taksat familjare për 9540 familje. Mos evidentimi i vlerës së debitorëve familjarë, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35; Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Gjetje nga auditimi:

Titulli Gjetjes	-Performancë e ulët në realizimin e të ardhurave.
Situata:	*Programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendorë, për vitin 2018, është miratuar në vlerën 92,990 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 59,879 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 33,111 mijë lekë, ose 64,3%. Detyrimet debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2018 janë në vlerën 23,410,462 mijë lekë nga 617 subjekte, nga të cilët 520 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 12,098 mijë lekë dhe 97 subjekte të biznesit të madh në vlerën 11,312 mijë lekë. Detyrimet debitorë për taksat dhe tarifatat familjare si dhe për taksën e tokës bujqësore janë në vlerën 19,932 mijë lekë për 9540 familje. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

	Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ultë për vitin 2018, ku ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e cila është programuar në masën 12,000 mijë lekë, realizuar në masën 7,228 mijë lekë ose 58% si dhe mos realizimi i të ardhurave nga tarifave lokale, si tarifa e shërbimit e cila është programuar në masën 15,000 mijë lekë, realizuar në masën 13,321 mijë lekë ose 88,8%.
Kriteri	-Aktet ligjore të sistemit të taksave dhe tarifave vendore, paketa fiskale miratuar me VKB.
Ndikimi/Efekti	- Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve
Shkaku	-Moszbatim i akteve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë për Taksat dhe Tarifave vendore.
Rëndësia:	-I Lartë
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Mat, që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.N. R. me detyrë, ish Kryetar i Bashkisë.

Z.B. B. me detyrë, Përgjegjës i Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore.

*Në lidhje me auditimin e kryer për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave nga zbatimi i tarifës së pagesës për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Mat, konstatohet se:

Sipas evidencës së paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake, sektori i infrastrukturës, lidhur me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e bashkisë Mat dhe në Njësitë Administrative në vartësi, u audituan për arkëtimin e tarifës për lëshimin e Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Mat. Subjektet që regëtojnë karburante për konsumatorët fundorë në Bashkisë Mat, me të dhënat si nipti, administratori, adresa ku ushtron aktivitetin, numri data dhe afati i fillimit dhe përfundimit të autorizimit/Licencës, paraqiten bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në auditimin e kryer, për zbatimin e legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, si dhe të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pikës 1, germës “b”; pika 6/1; dhe pika 9-VKB nr.69, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër, u konstatua se:

-Nga 12 subjekte që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Mat, në 5 (pesë) prej tyre nuk disponojnë licencë, u ka përfunduar afati i përdorimit dhe për rrjedhojë duhet të përsëriteshin dhe të paguanin tarifën përkatëse.

Në 5 raste nga sektori i transportit, nuk janë pajisur subjektet, me autorizim/licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nga Drejtoria e të Ardhurave nuk është arkëtuar tarifa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, në shkelje të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9; si dhe-VKB nr.69, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër. Subjektet sipas vendndodhjes ku ushtrojnë aktivitetin e tyre të biznesit sipas Njësive Administrative, nipti përkatës dhe vlera e tarifës së pa likuiduar për çdo subjekt, paraqiten bashkangjitur Projektraportit të Auditimit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga Drejtoria e shërbimeve bashkiake, sektori i infrastrukturës, Bashkia Mat, nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të trajtuara në aneksin nr.B/4. jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9 dhe të VKB nr.69, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Mat, sipas aneksit nr.1, në 5 raste në vlerën 5,000,000 lekë.

Gjetje nga auditimi

Titulli Gjetjes	-Mos arkëtim tarife nga mos dhënia e Licencave për tregti karburanti.
Situata:	-Nuk është vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.
Kriteri	-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017
Ndikimi/Efekti	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I lartë.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Mat, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën 5,000,000 lekë .

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. B. B. me detyrë, përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Z. A. P., me detyrë specialist i licensimit, drejtoria e shërbimeve bashkiake.

*Në auditimin e kryer për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave nga zbatimi i tarifës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimeve pa leje në territorin e bashkisë Mat.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Zyra e taksave, Zyra e administrimit Aseteve dhe Drejtoria e Planifikimit Territorit kanë rakorduar me Drejtorinë Rajonale të ALUZNIT, për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, në përputhje me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë. (Gjatë periudhë së auditimit në bashkëpunim me ALUIZNIN të nxirren listat e personave që duhet të paguanin, sa kanë paguar dhe sa nuk kanë paguar deri në periudhën e auditimit)

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e ALUIZNI- Drejtoria Dibër, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2018, në zbatim të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Gjatë vitit 2018 nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Dibër, janë dërguar shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të bashkisë Mat. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, konstatohet se nga Bashkia Mat, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Dibër.

Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, vendndodhja e objektit dhe detyrimi i pa likuiduar sipas aneksit nr.1.

Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Mat, konstatohet se deri më 31.12.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 83 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 22325,84 m². Veprimi dhe mosveprimi janë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe -VKB nr.33, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër, sipas aneksit nr.1, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 2,853,017 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Nga Bashkia Mat, Zyra e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Dibër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Mat, konstatohet se deri më 31.12.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 83 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 22325,84 m², jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe - VKB nr.33, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër, sipas aneksit nr.1 me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,853,017 lekë.

Gjetje nga auditimi:

Titulli Gjetjes	-Taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore, Aluizni.
Situata:	-Nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-
Kriteri	Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, VKB nr.33, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”,
Ndikimi/Efekt	- Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve
Shkaku	-Moszbatim i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I ulët.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Mat, që të zbatohen procedurat ligjore për kërkimin e detyrimit në vlerën 2,853,017 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. A. D. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës.

Z. B. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave;

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat për të dy vitet është bërë përcaktimi i tyre në vlerë për çdo program, por edhe i detajuar.

Faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” si gjendje në fund të vitit 2018 paraqiten në aneksin bashkangjitur Projektraportit të auditivit.

Efektet e zbatimit të vendimeve gjyqësore në buxhet.

-Bashkia Mat ka administruar 3 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 30,655,159 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat, një rast për “detyrim kontrate” në vlerën 27,253,209 lekë, detyrim nga ish Komuna Rukaj për dy kontrata të realizuara por të pa financuara totalisht dhe konkretisht për Objektin Ndërtim Ura Urakë e financiar pjesërisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Rikonstruksion Shkolla Bruc me burim financimi FZHR e pa financiar totalisht. Detyrimi për këtë vendim gjyqësor më 01.01.2018 ka qenë 27,253,209 lekë , ku gjatë vitit 2018 janë paguar nga Bashkia Mat me burimet e saj 2,000,000 lekë dhe shuma prej 11,811,744 lekë është çelur nga Ministria e Financave me kod projekti . Përsa i përket dy vendimeve gjyqësore të tjera janë për largim nga puna ku nga bashkia është bërë një likuidim për në shumën 800,000 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Faturat e pa likuiduara

Nga auditimi u konstatua se treguesit e buxhetit për vitin 2018 janë realizuar në masën 85%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve, Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë Investimet në masën 57% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë nuk janë kryer likuidimet brenda vitit.

Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2018 Bashkia Mat ka një detyrim ndaj të tretëve prej **73,014,051 lekë** (llogaria 401 & 467 furnitor e llogari të lidhura me to). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*.

Faturat e pa likuiduara janë raportuar çdo tre-mujor në Ministrinë e Financave. Për vitin 2018 shumë fatura nuk janë likuiduar në afat për arsye të limit të vendosur nga Ministria e Financave në Degën e Thesarit. Në total sipas zërave faturat e pa likuiduara paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme e konkretisht për faturat e pa likuiduara për Investimet e kryera, për faturat e pa likuiduara për vendimet e gjykatave dhe për faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 “Shpenzime operative” dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 401& 467 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe “kreditorë të ndryshëm”.

Pasqyra e faturave të pa likuiduara sipas viteve paraqitet në tabelën në vijim:

Nr	EMËRTIMI	Raste	Fatura te p likuiduar deri n 31.12.2018
1	INVESTIME	8	14,904,892
2	VENDIME GJYKATE	3	16,043,466
3	FATURA TE PALIKUJDUARA DHE TE TJERA	110	42,065,693
TOTALI			73,014,051

Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik është në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 ku citohet: *Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.*

Ndikimi në shkurtimet e buxhetit apo bllokimi nga MFE në fund të vitit në krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vitin 2018 janë 2 fatura që mbajnë data të fund vitit 2017, dhe të tjerat janë fatura që datojnë në fund të vitit 2018 të cilat nuk janë likuiduar për arsye limit, mosrealizim të të ardhurave, disa prokurime të kryera me vonesë si dhe faturat e muajit dhjetor që likuidohen në janar të vitit pasardhës, si shpenzime për ujë, energji, postë etj.

Nga Bashkia Mat të gjitha faturat janë regjistruar si detyrime të prapambetura në sistemin e Thesarit. Duhet theksuar fakti se detyrimet që përbëhet nga këto fatura është në vlerën **73,014,051 lekë**. Në Bashkinë Mat të gjitha likuidimet janë kryer pas kryerjes së punës apo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

shërbimit apo pas mbërritjes së mallit në institucion. Mjafton të kujtojmë faktin se shuma e faturave të likuiduara në muajin dhjetor të secilit vit është e njëjtë me ato të muajve të tjerë, madje dhe më e madhe për shkak të limitit të cashit.

Nuk ka patur raste të mos regjistrimit në kohë të dokumentacionit nga zyra e financës, është bërë kontrolli dhe pastaj pagesa në Degën e Thesarit Mat, përjashtim bëjnë raste pas vendosjes së limitit të shpenzimeve në muajt nëntor, dhjetor 2018. Nuk janë likuiduar shumica e faturave kapitale dhe të tjera në fund të vitit ushtrimorë, por sipas procedurave të realizimit të punëve apo shërbimeve. Muajt nëntor-dhjetor janë thuajse të njëjtë me muajt e tjerë të vitit sa i përket faturimeve të ndryshme. Buxheti që në fillim të vitit kalendarik është detajuar për çdo muaj dhe procedurat e prokurimit janë kryer sipas fondeve të disponueshme sipas regjistrimit të parashikimeve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Bashkia Mat ka përfituar një investim nga Fondi i Zhvillimi të Rajoneve me objekt “Sistemim i qendrës së qytetit dhe fasadave të pallateve”. Ky investim është akoma në proces pasi nuk është plotësuar afati për likuidimin e garancisë së defekteve. Kontabilizimi është bërë për vlerën e plotë i klasifikuar si vlerë kapitale në shumën 89,676,785 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

****Nga auditimi u konstatua se është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit Mat, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Mat duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës në vijim përfshirë edhe fondet e deleguara si dhe të ardhura nga FZHR:***

****Nga auditimi u konstatua se për vitin 2018 treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 85% ose nga 903,461 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 769,221 mijë lekë. Në zërin investime, buxheti është realizuar në masën 57% ose nga 145,946 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 83,853 mijë lekë.***

Të ardhurat e veta, për vitin 2018 janë realizuar në masën 64% ose nga 92,990 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 59,879 mijë lekë.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve, Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë Investimet në masën 57% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë nuk janë kryer likuidimet brenda vitit.

Buxheti për vitin 2018 është miratuar me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mat me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti me shkresën nr.778/1 prot date 23.05.2018.

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2018 është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Gjetje nga auditimi:

Titulli Gjetjes	-Zbatimi i Buxhetit
Situata:	<p>-Për vitin 2018 buxheti është realizuar në masën 85% ose nga 903,461 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 769,221 mijë lekë. Në zërin investime, buxheti është realizuar në masën 57% ose nga 145,946 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 83,853 mijë lekë.</p> <p>Të ardhurat e veta, për vitin 2018 janë realizuar në masën 64% ose nga 92,990 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 59,879 mijë lekë.</p> <p>Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve, Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë Investimet në masën 57% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë nuk janë kryer likuidimet brenda vitit.</p> <p>Buxheti për vitin 2018 është miratuar me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mat me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti me shkresën nr.778/1 prot date 23.05.2018.</p> <p><i>Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2018 është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</i></p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,</p> <p>-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar,</p> <p>-Ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”,</p> <p>-Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,</p> <p>-UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe</p> <p>-UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</p>
Ndikimi/Efekt i:	<p>-Mos realizim i treguesve të zbatimit të buxhetit, në total treguesit e shpenzimeve të buxhetit buxhetit për vitin 2018 janë realizuar në masën 85% , të ardhurat e veta janë realizuar 64% dhe Investimet janë realizuar 57%.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Shkaku:	- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I Lartë
Rekomandimi :	Të merren masa nga Bashkia Mat, që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të hartojë një buxhet sa më real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nga auditimi u konstatua se sipas të dhënave Buxhetit dhe të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **73,014,051 lekë, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën **14,904,892 lekë**, për 8 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën **42,065,693 lekë**, për 110 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën **16,043,466 lekë**, në 3 raste.*

Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 ⁽²⁾-E drejta për të kryer shpenzime,

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

-Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Gjetje nga auditimi:

Titulli Gjetjes	-Faturat e pa likuiduara
Situata:	-Totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 73,014,051 lekë , ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 14,904,892 lekë , për 8 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 42,065,693 lekë , për 110 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 16,043,466 lekë , në 3 raste.
Kriteri	-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, i ndryshuar me ligjin nr.114/2012/ datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 ⁽³⁾ -E drejta për të kryer shpenzime, -VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. I, pika 1. -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014. -Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, -Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

²⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Ndikimi/Efekti	-Mos realizim i treguesve të zbatimit të buxhetit, në total treguesit e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2018 janë realizuar në masën 85%.
Shkaku	- Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I Lartë.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Mat, që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.N. R. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë.

Znj.D. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin-2018, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në: udhëzimin e MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme“, etj.

1.1 Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike:

Në auditimin e kryer për plotësimin, hartimin, dorëzimin dhe miratimin e Pasqyrave Financiare në institucionet e prore u konstatua se, nga Bashkia Mat, Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit 2018 janë depozituar në degën e Thesarit me shkresën nr.917 prot datë 27.03.2019, janë miratuar nga Dega e Thesarit Mat me nr. 151 prot datë 27.03.2019, të cilat janë nënshkruar pa vërejtje prej tyre. Është respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës. Është plotësuar bilanci si dhe pasqyrat anekse të tij. Aktivi dhe pasivi i bilancit është i kundruar. Pasqyrat anekse rakordojnë me aktivin dhe pasivin e bilancit për llogaritë analoge. Pasqyra e shpenzimeve të ushtrimit dhe pasqyra e të ardhurave të ushtrimit kuadrojnë me akt-rakordimet me thesarin për shpenzimet dhe për të ardhurat. Gjithashtu gjendjet e llogarive në pasqyrën e lëvizjeve në “CASH” rakordojnë me akt-rakordimet me thesarin. Gjendja e llogarisë “Teprica në mbyllje të ushtrimit” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në aktivin e bilancit. Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2018 paraqiten në aneksin bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Mat janë të shoqëruara me situacionin e rakorduar për shpenzimet dhe të ardhurat, vetëm për Bashkinë Mat, pasi për institucionet vartëse nuk janë hartuar pasqyrat e konsoliduara. Nisur nga fakti se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë dhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. U krye kontrolli aritmetik, për tu siguruar në se veprimet e llogaritjes dhe të regjistrimit në llogaritë përkatëse, të cilat përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, rezultuan të sakta.

Shumat e llogarive të paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, kuadrojnë me shumat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Formati nr.2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Formati nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash flow), Formati nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Formati nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e raportimi pasqyrave financiare vjetore), Formati nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Formati nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Formati



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Formati nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Në zbatim UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si bazë e dhënies së opinionit të raportimit financiar është dhe saktësia e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare, për të cilën u analizuan treguesit e kësaj njësie publike për aktivitetin ekonomik financiar.

Ndërsa baza e dhënies së opinionit të raportimit financiar është edhe saktësia e paraqitjes së zërave për aktivitetin ekonomik financiar të paraqitura në ndërtimin e mbylljen e pasqyrave financiare për periudhën raportuese 2018, është edhe krahasimi me gjendjen e llogarive të mbartura nga periudha e mëparshme 2017 të pasqyruara me vlerën neto, ku gjendja e përgjithshme me analizë paraqitet me të dhënat në vijim:

Aktivi i Bilancit:

-Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 109,411,083 lekë dhe përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen për vitin 2018 të cilat përbëhen nga rezultati i veprimtarisë ushtrimore në vlerën 87,587,303 lekë dhe kreditorë për mjete në ruajtje në vlerën 21,823,778 lekë, ndërsa më 31.12.2018, rezulton në vlerën 119,345,093 lekë e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm të cilat përbëhen nga rezultati i veprimtarisë ushtrimore në vlerën 103,204,093 lekë dhe kreditorë për mjete në ruajtje në vlerën 16,141,000 lekë.

-Gjendja e llogarisë 31 “Materiale” të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 6,721,870 lekë dhe konkretisht vlera prej 338,016 lekë trashëguar nga ish Komuna Derjan dhe vlera prej 6,383,854 lekë nga dy magazinat e Bashkisë, ndërsa në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 4,612,523 lekë, nga të cilat Njësia Administrative Derjan paraqitet vlera prej 220,836 lekë dhe vlera prej 4,391,687 lekë nga Magazinat e Bashkisë Mat. Ndryshimet në llogarinë 31 vijnë si rezultat i shtesave prej 40,411,616 lekë blerje ushqime për kopshtet, çerdhet dhe konviktet dhe materiale të tjera të ndryshme si dhe pakësimet që vijnë për daljet nga magazinat sipas planit të shpërndarjes dhe nga daljet jashtë përdorimit në vlerën 42,526,933 lekë.

-Gjendja e llogarisë 32 “inventar i imët” të gjendjeve të inventarit qarkullues, në aktivet afat shkurtra, në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 45,964,204 lekë të trashëguara nga ish Komunitat dhe ish Bashkia Burrel, ndërsa në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 46,605,827 lekë. Ndryshimet në llogarinë 32 Inventar i imët vijnë si rezultat i shtesave prej 641,623 lekë. Në total llogaritë Gjendje inventari qarkullues që përfaqësojnë llogaritë 31 dhe 32 paraqiten me vlerën 52,686,074 lekë në fillim të vitit 2018 dhe vlera 51,218,350 lekë në fund të vitit 2018 me një ndryshim gjendje me pakësim në vlerën 1,467,724 lekë.

-Llogaritë e klasës katër llogari të arkëtueshme në debit të tyre paraqiten për shumën 96,067,645 lekë në fillim të vitit 2018 dhe në fund të vitit 2018 në vlerën 112,221,078 lekë.

-Llogaria 423 “personeli, paradhënie, deficite e gjoba” është e pandryshueshme si në fillim dhe në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 16,416,542 lekë. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet e akt kontrollit të KLSH ndër vite.

-Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” e cila rezulton në fillim dhe në fund të vitit 2018 përkatësisht në vlerën 41,896,192 lekë dhe në vlerën 47,702,992 lekë, sipas pasqyrës bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Gjendja e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm” e cila rezulton në fund të vitit 2018 në vlerën



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

47,702,992 lekë, e cila përbëhet nga debitorët e biznesit të vogël dhe debitorët e biznesit të madh dhe vip, në vlerën 40,856,648 lekë dhe gjoba dhe detyrime të lëna nga kontrollet e viteve të mëparshme nga auditimi i KLSH-së dhe i Prefekturës, për 7 NJA, në vlerën 6,846,344 lekë. Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore. Kontabiliteti i detyrimeve për taksat dhe tarifatat Vendore ndiqet nga Sektori i Taksave Tarifave Vendore. Vlera e pasqyruar në kontabilitet për debitorët e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë të përfshirë detyrimet familjare për taksat dhe tarifatat vendore familjare. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018. Në këto kushte, pasqyrat financiare nuk janë reale pasi llogaritë debitorë për shumën e detyrimeve Tatim Taksat Lokale, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për vlerën 19,932 mijë lekë, detyrime për taksat familjare për 9540 familje. Mos evidentimi i vlerës së debitorëve familjarë, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 37,754,911 lekë, ndërsa në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 48,101,544 lekë, të cilat përfaqësojnë të drejtat për pagat e dhjetorit 2018 në vlerën 13,597,328 lekë, sigurime shoqërore në vlerën 4,029,432 lekë, sigurime shëndetësore në vlerën 553,111 lekë, tatime në vlerën 732,869 lekë, fatura të papaguara në llogarinë 401 në vlerën 11,421,208 lekë dhe detyrime të tjera të papaguara në llogarinë 467 në shumën 17,767,596 lekë.

-Të tjera aktive afatshkurtra që përfaqëson llogarinë 486 “shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet me vlerën 32,904,788 lekë fillim të vitit 2018 dhe në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 43,825,147 lekë. Kjo vlerë përfaqëson faturat e papaguara të cilave ju ka kaluar afati 30 ditor dhe janë raportuar në Degën e Thesarit jashtë afatit 30 ditor dhe është e barabartë me llogarinë 467.

-Gjendja e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 26,701,445 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studim projekteve për investime në vite. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

...në 31 raste janë studime e kërkime në vlerën 10,474,397 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara ish Bashkia Burrel dhe nga 7 ish Komunitat të cilat janë përthithur nga Bashkia Mat.

...në 13 raste janë studime e kërkime në vlerën **16,167,048 lekë** i përkasin investimeve për objekte të pafinancuara në vitet e kaluar e në vijim të Bashkisë Mat dhe konkretisht në NJA Komsit janë objekte të pafinancuara në vlerën 493,680 lekë, në NJA Lis janë objekte të pafinancuara në vlerën 814,400 lekë, në NJA Burrel 14,761,048 lekë, në Bordin e Kullimit në vlerën 97,920 lekë dhe në Njësinë Administrative Baz,

...në 2 raste janë studime e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në aktiv të pasqyrave financiare.

Si përfundim konstatohet se:

....për 31 rastet e studimeve e kërkimeve në vlerën 10,474,398 lekë, duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

....për 2 rastet e studimeve e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në aktiv të pasqyrave financiare.

Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

-Gjendja në llogarinë sintetike “Aktive Afatgjata materiale” në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 2,276,519,235 lekë, ndërsa në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 1,709,129,563 lekë, me një pakësim në vlerën 567,389,672 lekë. Këto ndryshime të detajuara paraqiten në vijim:

-Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 26,247,728 lekë, ndërsa në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 27,362,728 lekë, vlerë e cila përbëhet nga vlera e objekteve si: Lulishte në shkolla Nj A Macukull, Tokë për varreza, terrene sportive dhe kënde të lojrave në ish Bashkinë Burrel etj. Shtesa prej 1,115,000 lekë përbën shpronësim toke për varreza në fshatin Mallunxë. Nga analiza e mëtejshme e kësaj llogarie konstatohet se:

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” si Godina e Bashkisë, Ndërtesat si: Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare; Ndërtesat e ish Ndërmarrjes Pyjore, Ndërtesat e ish Komunave sot Njësi Administrative.

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

Mos evidentimi i vlerës së trojeve të objekteve dhe vlerës së trojeve të lira dhe të objekteve sipas VKM-ve, dhe mos kryerja e inventarizimit dhe vlerësimit të trojeve dhe terreneve, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 10,550,203 lekë. Në këtë llogari janë të përfshira Pyllëzime me arrorë Nj A Macukull, Pyje e kullota Nj A Rukaj, sistemime dhe gjelbërimi në Nj A Baz dhe Ndërmarrja e Shërbimeve. Nga analiza e mëtejshme e kësaj llogarie konstatohet se:

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Mat, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 10, shtojca me nr.8, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Mat, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Mos evidentimi i vlerës së pyjeve dhe kullotave dhe mos kryerja e inventarizimit dhe vlerësimit të pyjeve dhe kullotave, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96.

-Gjendja në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet përkatësisht në vlerën 789,221,788 lekë dhe në vlerën 803,622,686 lekë, e cila rezulton me shtesë në vlerën 56,696,829 lekë dhe përbëhet nga vlera e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “31 korriku” dhe shkollës Bruç, vlera e objektit për rehabilitimin e nyjes sanitare shkolla Gjalish, ndërsa pakësimi në vlerën 42,295,929 lekë është amortizimi vjetor.

-Gjendja në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet përkatësisht në vlerën 1,403,434,550 lekë dhe në vlerën 828,258,727 lekë. Ndryshimet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesat në vlerën 27,791,587 lekë që përfaqësojnë investime të përfunduara në rrugë, ujësjellës e kanale si dhe pakësimet janë në vlerën 553,017,887 lekë pakësime për transferimin e Ujësjellësve të Njësi Administrative, Koms, Baz, Ulëz, Lis e Macukull pranë UK SHA Mat dhe pakësim në vlerën 3,616,200 lekë blerje pllaka për sheshin pranë Ndërmarrjes Shërbimeve të Bashkisë si Njësi vartëse e Bashkisë Mat si dhe pakësimi tjetër vjen nga amortizimi vjetor në vlerën 46,333,323 lekë.

-Gjendja e llogarisë 214 “instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet përkatësisht në vlerën 7,698,963 lekë dhe në vlerën 5,951,211 lekë, lëvizjet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesa në vlerën 879,311 lekë për dalje jashtë përdorimi në vlerën 1,534,935, zbritje amortizimi për dalje jashtë përdorimi në vlerën 459,477 lekë, amortizimi vjetor në vlerën 428,914 lekë, transferim pranë Ndërmarrjes Shërbimeve Bashkiake 779,411 lekë dhe sistemim nga një llogari në një tjetër në vlerën 343,560 lekë pasi llogaria është paraqitur në vlerë neto.

-Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet përkatësisht në vlerën 17,266,110 lekë dhe në vlerën 15,344,888 lekë, lëvizjet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesa në vlerën 246,000 lekë blerje mjet transporti për punëtorë i bërë hyrje në vitin 2017 por i likuiduar në vitin 2018 pra kalim nga llogaria 231 në llogarinë 215 sistemim në vlerën 1,286,000 lekë sa paraqitur me pak në bilancin e vitit 2017, pakësim është zbritje amortizimi vjetor në vlerën 3,453,222 lekë.

-Gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet përkatësisht në vlerën 22,099,893 lekë dhe në vlerën 18,039,120 lekë, ndryshimet në këtë llogari kanë të bëjnë me shtesa në vlerën 6,533,853 lekë, për dalje jashtë përdorimi në vlerën 4,804,475 lekë, zbritje amortizimi për dalje jashtë përdorimi në vlerën 140,223 lekë, vlera e amortizimit vjetor në vlerën 5,930,373 lekë.

-Gjendja e llogarisë 231 “Për Aktive Afatgjata materiale”, në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet përkatësisht në vlerën 491,000 lekë dhe në vlerën zero lekë, ndryshimet në këtë llogari në vlerën 491,000 lekë pakësim, kanë të bëjnë me kalimin nga llogaria 231 tek llogaria 215 për blerje mjet transporti për punëtorë në vlerën 246,000 lekë dhe kalimin nga llogaria 231 tek llogaria 218 inventar ekonomik për blerje tabela për zyrat me një ndalesë në vlerën 245,000 lekë.

Pasivi i Bilancit:

Gjendja e fondeve të veta në fillim dhe në fund të vitit 2018, paraqitet përkatësisht në vlerën 2,194,842 101 lekë dhe në vlerën 1,781,046,453 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Sipas të dhënave të bilancit në pikën II-të “Detyrimet afatshkurta” paraqiten në fillim dhe në fund të vitit 2018, përkatësisht në vlerën 150,801,911 lekë dhe në vlerën 172,187,325 lekë, nga të cilat konstatohet se:

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, më 31.12.2018 paraqitet në vlerën 11,421,208 lekë e cila përbëhet nga fatura të papaguara të muajit dhjetor si energji elektrike, telefon, ujë dhe shpenzime postare, nga ana e bashkisë Mat si dhe detyrime të tjera për shpenzime operative (llogaria ekonomike 401), me burim likuidimi shpenzimet operative (llogaria ekonomike 602). Trajtuar më hollësisht tek akt konstatimi i Buxhetit.

-Gjendja e llogarisë 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, më 31.12.2018 paraqet në kredi të sajë në vlerën 13,597,328 lekë.

-Gjendja e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në 31.12.2018 në vlerën 732,869 lekë, të cilat janë detyrime për tatimin mbi pagë të personelit për muajin dhjetor të vitit ushtrimor.

-Llogaria 435-436 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” paraqesin detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa derdhura të muajit dhjetor të vitit ushtrimor 2018 në vlerën 4,582,543 lekë.

-Llogaria 467 kreditorë të ndryshëm paraqet detyrimet për fatura të palikudjuara të cilat ju ka kaluar afati 30 ditor, shpërblime anëtarët e këshillit bashkiak, kryetarë të fshatrave që i përkasin periudhave përpara muajit dhjetor si dhe paga të prapambetura të cilat me udhëzimin e ri kontabilizohen në degën e Thesarit në këtë llogari e cila në vitin 2018 paraqitet në vlerën 61,592,843 lekë. Trajtuar më hollësisht tek akt konstatimi i Buxhetit.

-Llogaria 4341 Operacione me shtetin detyrime që ka të bëjë me llogarinë 468 dhe 423 në aktiv të bilancit paraqitet me vlerën 58,318,434 lekë në fillim të vitit 2018 dhe në vlerën 64,119,534 lekë, në fund të vitit 2018.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në pasiv të bilancit në vlerën 16,141,000 lekë e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme, për garanci punimesh të përcaktuara në kontratat e lidhur midis palëve, gjendje më 31.12.2018.

Nga analiza e kësaj llogarie, rezulton se vlera 16,141,000 lekë përbëhet si vijon:

.....vlera 10,916,020 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018,

....vlera 5,224,980 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera gjatë vitit 2018, të cilat janë brenda afatit të garancisë të përcaktuar në kontratë.

konstatohet se:

.....vlera 10,916,020 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018, të cilat ju ka përfunduar afati i caktuar në kontratë. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar prej 10,916,020 lekë.

Mos sistemimi i vlerës së garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e pasiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Pasqyrat financiare mbajnë nënshkrimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit zbatues si dhe vulën e Institucionit në formatin e Bilancit. Ato janë dërguar në Degën e Thesarit me shkresën nr.917 prot datë 27.03.2019, janë miratuar nga Dega e Thesarit Mat me nr. 151 prot datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

27.03.2019. Gjendja e llogarisë së thesarit në fund të secilës periudhe ushtrimore është pasqyruar saktë, për vitin 2018 vlera është 119,345,093 lekë. Vlerat është e barabartë me Akt rakordimin e mbajtur me Degën e Thesarit Mat. Për realizimin e shpenzimeve nga ana e Bashkisë Mat janë mbajtur Akt rakordime me Degën e Thesarit Mat çdo muaj. Akt rakordimi i muajit Dhjetor të fund vitit përputhet me Pasqyrat financiare.

Detyrimet e muajit Dhjetor janë likuiduar në Janar të vitit pasardhës, në rakordim të plotë me klasën përkatëse të Pasqyrave Financiare. Bashkia Mat nuk ka asnjë rast ku është marrë ndonjë shërbim apo mall pa u shoqëruar me faturat përkatëse. Sa i përket pagave, sigurimeve shoqërore, tatimit mbi pagë dhe shpenzimeve operative të faturave të muajit dhjetor që ekzekutohen në muajin Janar të vitit pasardhës situata paraqitet sipas pasqyrës bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa i përket zërit “Të drejta të arkëtueshme nga të tretët” konstatohet se Bashkia Mat ka kontabilizuar saktë dhe rregullisht të gjitha detyrimet që rrjedhin nga taksat vendore. Kjo kategori paraqitet në vlerën 47,702,992 lekë shumë kjo e paraqitur në llogarinë 468 në aktiv të Bilancit. Nga ana e Bashkisë janë bërë përpjekje për vjeljen e këtyre detyrimeve, por në disa raste këto përpjekje nuk kane rezultuar pozitive. Bashkia Mat ka regjistruar në kohë dhe në përputhje me legjislacionin të gjitha faturat e detyrimeve të prapambetura. Ky veprim është qartësisht i dukshëm dhe në pasqyrat financiare në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ku për vitin 2018 vlera është 43,825,247 lekë e analizuar sipas pasqyrës bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në fund të viti 2018, Bashkia Mat është përballur me limitin e cashit e cila ka krijuar detyrime të prapambetura për vlerën e punimeve dhe vlerën e shërbimeve të kryera të faturuara dhe të palikuiduara. Detyrimet për arsye limiti të cashit paraqitën në vlerën 12,850,000 lekë për vitin 2018. Në këto shuma janë dhe detyrimet e muajit Dhjetor të fundvitit. Transferta e pakushtëzuar e cila për arsye limiti apo arsye të tjera ka rezultuar e papërdorur në fund të vitit është trashëguar në vitin pasardhës. Në pasqyrat financiare është kontabilizuar saktë vlera. Për vitin 2018 vlera është 119,345,093 lekë. Vlera është e barabartë me Akt rakordimet e mbajtura me Degën e Thesarit Mat. Bashkia Mat nuk ka marrë hua dhe për rrjedhojë nuk ka hua të pashlyera.

Sa i përket garancive të punimeve të kryera ato paraqiten për vitin 2018 paraqitën në vlerën 16,141,000 lekë të regjistruara në llogarinë 466. Bashkia Mat nuk ka detyrime të mbartura ndaj OSHEE dhe Ujësjiellës kanalizim sha. Janë kryer rregullisht pagesat për këto detyrime. Bëjnë përjashtim detyrime e muajit Dhjetor të cilat paguhen në Janar të vitit pasardhës, të cilat janë kontabilizuar saktë. Bashkia Mat nuk ka shpenzime me financim të huaj.

Bashkia Mat ka listën e plotë të vendimeve gjyqësore sipas detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. Pranë zyrës së Financës janë depozituar 3 vendime të formës së prerë për të cilat kanë dalë dhe urdhrat e përmbarimit me një vlerë prej 16,043,466 lekë. Kjo shumë është paraqitur dhe në pasqyrat financiare dhe kontabilizimi është bërë saktë. Shuma prej 16,043,466 lekë është gjendja në fund të vitit 2018 për detyrime të pashlyera për vendime gjyqësore.

Janë kryer çdo vit inventarizimi i Aktiveve Afatgjata të Trupëzuara me komisione të posaçme të ngritura me urdhrat përkatës, për vitin 2018 me nr.387, datë 04.12.2018. Përmirësimet janë pasqyruar si shtesa kapitale dhe janë kontabilizuar saktë. Amortizimi është regjistruar saktë. Normat e amortizimit janë në përputhje me Udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. Për rastet e nxjerrjeve jashtë përdorimi është ndjekur rruga ligjore me ngritjen e komisionit përkatës me Urdhër nr.596, datë 14.11.2017 për vlerësimin e Aseteve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

identifikuara si të papërdorshme dhe për nxjerrje jashtë përdorimi. Me urdhrin e Kryetarit nr.70 datë 19.02.2018 u ngrit komisioni për asgjësimin e këtyre materialeve. Efektet e nxjerrjeve jashtë përdorimi janë pasqyrat dhe në pasqyrat financiare.

Është kryer çdo vit inventarizimi i Aktiveve Afatgjata të Patrupëzuara me komisione të posaçme të ngritura me urdhrat përkatës, për vitin 2018 me nr. 387, datë 04.12.2018. Klasifikimi i tyre është i saktë. Janë pasqyruar saktë të gjitha shtesat ndër vite. Nuk ka patur raste të prishjes, dëmtimeve, humbje apo nxjerrje jashtë përdorimi. Amortizimi është regjistruar saktë. Normat e amortizimit janë në përputhje me Udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. Për rastet e nxjerrjeve jashtë përdorimi është ndjekur rruga ligjore me ngritjen e komisionit përkatës me Urdhër nr. . 387, datë 04.12.2018 për vlerësimin e Aseteve të identifikuara si të papërdorshme.

Mbi Hartimin e Pasqyrave financiare të konsoliduara

Nga Bashkia Mat, nuk na u paraqitën pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për periudhën janar – dhjetor të vitit ushtrimor 2018, ku përveç pasqyrave financiare të njësisë Bashkia Mat të përfshiheshin edhe pasqyrat financiare të 3 (tre) njësi vartëse e përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjellësit sha.

Hartimi i informacionit kontabël të konsoliduar në njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështetet në parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit dhe të përgatitjes e paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore individuale të njësive, për nivelet përkatëse të qeverisjes në të cilat bëhet konsolidimi i informacionit. Ky konsolidim është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të prodhohet një informacion i dobishëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm, në shërbim të vendimmarrjeve të qeverisjes së përgjithshme, në nivele qendrore dhe lokale.

Nisur nga fakti se Pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara kanë si qëllim të përgjithshëm dhënien e informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, nëpërmjet: Sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimin e tyre; Sigurimit të informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësive dhe realizimin e kërkesave mbi mjetet monetare; Sigurimit të informacionit që lidhet me aftësinë e njësive për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet; si dhe Sigurimit të informacionit për vlerësimin e performancës së njësive raportuese.

Mos hartimi i pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduar nuk mundëson grupimin e informacioni, duke bërë eliminimet dhe duke mënjeluar dublimet, për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” pika 98, 99,100,101 germa “b”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare mbi saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, u konstatuan pasaktësi në disa llogari:

-Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

-Në llogarinë 202 “Aktive Afatgjata jo materiale”, nuk është sistemuar vlera prej 10,474,398 lekë që i përkasin 31 raste studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2018, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe për 2 rastet e studimeve e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në aktiv të pasqyrave financiare.

-Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave si Godina e Bashkisë, Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare, Ndërtesat e ish Ndërmarrjes Pyjore, Ndërtesat e ish Komunave sot NjA dhe vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve.

-Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Mat, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 10, shtojca me nr.8, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy), nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në llogarinë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nuk është sistemuar vlera prej 10,916,020 lekë, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të bizneseve.

-Nuk janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për bashkinë dhe të 3 (tre) njësite vartëse përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjiellit sha. Nga mos hartimi i pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara nuk mundëson grupimin e informacioni, duke bërë eliminimet dhe duke mënjanuar dublimet, për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë, sjell mungesë të informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, rreth burimeve financiare.

Gjetje nga Auditimi:

Titulli gjetjes:	Mbi saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare për dhënien e opinionit.
Situata:	<p>Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare mbi saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, u konstatuan pasaktësi në disa llogari:</p> <p>-Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore,</p> <p>-Në llogarinë 202 “Aktive Afatgjata jo materiale”, nuk është sistemuar vlera prej 10,474,398 lekë që i përkasin 31 raste studimeve, kërkimeve dhe projekteve për investimet e kryera në periudhën para vitit 2018, për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe për 2 rastet e studimeve e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në aktiv të pasqyrave financiare.</p> <p>-Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave si Godina e Bashkisë, Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare, Ndërtesat e ish Ndërmarrjes Pyjore, Ndërtesat e ish Komunave sot NjA dhe vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat, nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve.</p> <p>-Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Mat, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

	<p>të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 10, shtojca me nr.8, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy), nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.</p> <p>-Në llogarinë nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, nuk është sistemuar vlera prej 10,916,020 lekë, pasi janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të bizneseve.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2;</p> <p>-VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 10, shtojca me nr.8, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy).</p> <p>-UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV, pika 74 dhe 96.</p> <p>-UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”</p>
Ndikimi/Efekti	-Pasaktësi në besueshmërinë e pasqyrave financiare.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuadrit ligjor për veprimet kontabël dhe pasqyrat financiare.
Rëndësia:	-I lartë.
Rekomandimi:	-Nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarive të pasqyrave financiare bazuar në dokumentacionin kontabël ligjor.

Gjetje nga auditimi.

Titulli Gjetjes	-Mbi hartimin e pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara.
Situata:	-Nuk janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për bashkinë dhe të 3 (tre) njësisë vartëse përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjetës së sha. Nga mos hartimi i pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara nuk mundëson grupimin e informacioni, duke bërë eliminimet dhe duke mënjeluar dublimet, për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë, sjell mungesë të informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, rreth burimeve financiare.
Kriteri	-UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” pika 98, 99,100,101 germa “b”.
Ndikimi/Efekti	-Mos pasqyrim i saktë dhe me vërtetësi i gjendjes së aktiveve.
Shkaku	-Moszbatim i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I lartë
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia Mat, Drejtoria e Financës, që të zbatohen procedurat ligjore për hartimin e pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara.

1.2 Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

Për vlerësimin dhe dhënien e opinionit të pasqyrave financiare të periudhës së vitit 2018, u analizuan të gjithë treguesit e aktivitetit të veprimtarisë ekonomiko financiare dhe në mënyrë përmbljedhëse është paraqitur së bashku me opinionin në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

1.3 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë; Për mënyrën e plotësimit të pasqyrave financiare, për saktësinë dhe analizën e llogarive të pasqyruara dhe të paraqitura në aktiv dhe në pasiv të bilancit janë trajtuar hollësisht në pikën një të programit, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike. Pasqyrat financiare të Bashkisë përbëhen nga pasqyrat financiare (bilanci) të institucionit më 31 Dhjetor 2018, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare (cash’floë), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit, pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra e numrit të punonjësve dhe e fondit të pagave, pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

1.4 Opinioni mbi pasqyrat financiare;

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko financiar 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018, është paraqitur së bashku me opinionin në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.N. R. me detyrë ish Kryetar i Bashkisë.

Znj.D. K. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

IV GJETJET DHE REKOMANDIMET

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 85% ose nga 903,461 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 769,221 mijë lekë. Në zërin investime, buxheti është realizuar në masën 57% ose nga 145,946 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 83,853 mijë lekë. Të ardhurat e veta, për vitin 2018 janë realizuar në masën 64% ose nga 92,990 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 59,879 mijë lekë. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave dhe mosrealizimi për efekt të vendosjes së limitit të likuidimeve nga Ministria e Financave, sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve, Peshën më të madhe të mosrealizimit e zënë Investimet në masën 57% ku ndër të tjera shkak i mosrealizimit është edhe vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe si rrjedhojë nuk janë kryer likuidimet brenda vitit.

Buxheti për vitin 2018 është miratuar me VKB nr.75, datë 29.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mat me shkresën nr. 12/1, datë 08/01/2018 dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2018 miratuar me VKB nr.36 date 18.05.2018 si dhe konfirmimi nga Prefekti me shkresën nr.778/1 prot date 23.05.2018. *Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2018*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, të marren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe brenda afateve ligjore, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

Në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e Buxhetit dhe të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2018 në Llog (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, dhe detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën **73,014,051 lekë**, ndaj subjekteve private, nga të cilat detyrime për Investime në vlerën 14,904,892 lekë, për 8 raste; detyrime për mallra e shërbime në vlerën 42,065,693 lekë, për 110 raste; detyrime për vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 16,043,466 lekë, në 3 raste.

Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 ⁽⁴⁾-E drejta për të kryer shpenzime,

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

-Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Mat, Sektori i Financës, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117-*Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të

⁴⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **73,014,051 lekë**, sipas Aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 31.12.2018, e rakorduar kjo me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e financave.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

3. Gjetje nga auditimi: Programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, për vitin 2018, është miratuar në vlerën 92,990 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 59,879 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 33,111 mijë lekë, ose 64,3%.

Detyrimet debitore të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2018 janë në vlerën 23,410,462 mijë lekë nga 617 subjekte, nga të cilët 520 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 12,098 mijë lekë dhe 97 subjekte të biznesit të madh në vlerën 11,312 mijë lekë.

Detyrimet debitore për taksat dhe tarifave familjare si dhe për taksën e tokës bujqësore janë në vlerën 19,932 mijë lekë për 9540 familje.

Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018.

Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ultë për vitin 2018, ku ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e cila është programuar në masën 12,000 mijë lekë, realizuar në masën 7,228 mijë lekë ose 58% si dhe mos realizimi i të ardhurave nga tarifave lokale, si tarifa e shërbimit e cila është programuar në masën 15,000 mijë lekë, realizuar në masën 13,321 mijë lekë ose 88,8%.

*Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore e bashkisë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura, të taksave dhe tarifave vendore, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mat, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 617 subjekte të biznesit të madh e të vogël, debitorë në vlerën 23,410,462 **lekë** dhe për 670 familje debitore për taksa e tarifave familjare dhe taksën e tokës bujqësore, në vlerën 19,932,000 lekë.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitor të ndryshëm” e cila rezulton në fund të vitit 2018 në vlerën 47,702,992 lekë, e cila përbëhet nga debitorët e biznesit të vogël dhe debitorët e biznesit të madh dhe vip, në vlerën 40,856,648 lekë dhe gjoba dhe detyrime të lëna nga kontrollet e viteve të mëparshme nga auditi i KLSH-së dhe i Prefekturës, për 7 NJA, në vlerën 6,846,344 lekë. Në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore. Kontabiliteti i detyrimeve për taksat dhe tarifave Vendore ndiqet nga Sektori i Taksave Tarifave Vendore. Vlera e pasqyruar në kontabilitet për debitorët e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë të përfshirë detyrimet familjare për taksat dhe tarifave vendore familjare. Nga sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë dorëzuar listat e debitorëve familjarë, në zyrën e financës për tu kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018. Në këto kushte, pasqyrat financiare nuk janë reale pasi llogaritë debitore për shumën e detyrimeve Tatim Taksat Lokale, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për vlerën 19,932 mijë lekë, detyrime për taksat familjare për 9540 familje. Mos evidentimi i vlerës së debitorëve familjarë, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Bashkia Mat, Sektori i Financës, dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për sistemimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” ku të evidentojnë vlerën 19,932 mijë lekë, nga 9540 familje, debitorë për detyrimet familjare, sipas regjistrave të zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019

5.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 26,701,445 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studim projekteve për investime në vite. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

...në 31 raste janë studime e kërkime në vlerën 10,474,397 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara ish Bashkia Burrel dhe nga 7 ish Komunat të cilat janë përthithur nga Bashkia Mat.

...në 13 raste janë studime e kërkime në vlerën 16,167,048 lekë i përkasin investimeve për objekte të pafinancuara në vitet e kaluar e në vijim të Bashkisë Mat dhe konkretisht në NJA Komsi janë objekte të pa financuara në vlerën 493,680 lekë, në NJA Lis janë objekte të pa financuara në vlerën 814,400 lekë, në NJA Burrel 14,761,048 lekë, në Bordin e Kullimit në vlerën 97,920 lekë dhe në Njësinë Administrative Baz,

...në 2 raste janë studime e kërkime në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në aktiv të pasqyrave financiare.

Si përfundim konstatohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

....për 31 rastet e studimeve e kërkimeve në vlerën 10,474,398 lekë, duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

....për 2 rastet e studimeve e kërkimeve në vlerën 60,000 lekë të cilat janë përfshirë gabimisht në llogarinë 202 të cilat duhet të ishin përfshirë në llogaritë e klasës 6 dhe nuk duhej të pasqyroheshin në në aktiv të pasqyrave financiare.

Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar dhe ato të pa financuara. Për vlerën **10,474,398 lekë**, llogaria 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duhet të pakësohet dhe kjo vlerë të shtohet në investimet e përfunduara sipas objekteve që u përkasin projektet, të sistemohet vlera **60,000 lekë** në llogaritë e klasës 6.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019

6.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në fillim të vitit 2018 paraqitet në vlerën 26,247,728 lekë, ndërsa në fund të vitit 2018, paraqitet në vlerën 27,362,728 lekë, vlerë e cila përbëhet nga vlera e objekteve si: Lulishte në shkolla Nj A Macukull, Tokë për varreza, terrene sportive dhe kënde të lojërave në ish Bashkinë Burrel etj. Shtesa prej 1,115,000 lekë përbën shpronësim toke për varreza në fshatin Mallunxë. Nga analiza e mëtejshme e kësaj llogarie konstatohet se:

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” si Godina e Bashkisë, Ndërtesat si: Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare; Ndërtesat e ish Ndërmarrjes Pyjore, Ndërtesat e ish Komunave sot Njësi Administrative.

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar edhe vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Mos evidentimi i vlerës së trojeve të objekteve dhe vlerës së trojeve të lira dhe të objekteve sipas VKM-ve, dhe mos kryerja e inventarizimit dhe vlerësimit të trojeve dhe terreneve, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë si dhe të kryhet inventarizimi i trojeve me komision.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

7.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fillim dhe në fund të vitit 2018 paraqitet e pa ndryshuar në vlerën 10,550,203 lekë. Në këtë llogari janë të përfshira Pyllëzime me arrorë Nj A Macukull, Pyje e kullota Nj A Rukaj, sistemime dhe gjelbërimi në Nj A Baz dhe Ndërmarrja e Shërbimeve. Nga analiza e mëtejshme e kësaj llogarie konstatohet se:

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Mat, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 10, shtojca me nr.8, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Mat, me numër rendor nga 1(një) deri 1752 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy). Mos evidentimi i vlerës së pyjeve dhe kullotave dhe mos kryerja e inventarizimit dhe vlerësimit të pyjeve dhe kullotave, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financiare nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Mat, Sektori i Financës, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin dhe evidentimin e pronave në llogarinë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në pasqyrat financiare, të cilat janë në pronësi të Bashkisë.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019

8.Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në pasiv të bilancit në vlerën 16,141,000 lekë e cila përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme, për garanci punimesh të përcaktuara në kontratat e lidhur midis palëve, gjendje më 31.12.2018.

Nga analiza e kësaj llogarie, rezulton se vlera 16,141,000 lekë përbëhet si vijon:

....vlera 10,916,020 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018,

....vlera 5,224,980 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera gjatë vitit 2018, të cilat janë brenda afatit të garancisë të përcaktuar në kontratë.

konstatohet se:

....vlera 10,916,020 lekë, janë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve për garanci punimesh të kryera para vitit 2018, të cilat ju ka përfunduar afati i caktuar në kontratë. Kjo vlerë duhet të sistemohet, të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin bashkangjitur për këtë qëllim në vlerën e sipër cituar prej 10,916,020 lekë. Mos sistemimi i vlerës së garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim, tregon se pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e pasiveve, veprimi dhe mos veprimi janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

8.1.Rekomandimi: Bashkia Mat, Sektori i Financës, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për sistemimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,916,020 lekë ku të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumenteve për sistemimin e vlerave sipas objekteve dhe subjekteve të paraqitur në aneksin nr.2 bashkangjitur

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Financës, Bashkia Mat, nuk janë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për vitin ushtrimor 2018, ku përveç pasqyrave financiare të njësisë Bashkia Mat të përfshiheshin edhe pasqyrat financiare të 3 (tre) njësi vartëse e përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjiellit sha. Hartimi i informacionit kontabël të konsoliduar në njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështetet në parimet dhe rregullat e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit dhe të përgatitjes e paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore individuale të njësisë, për nivelet përkatëse të qeverisjes në të cilat bëhet konsolidimi i informacionit. Ky konsolidim është shumë i rëndësishëm në mënyrë që të prodhohet një informacion i dobishëm, i kuptueshëm dhe i besueshëm, në shërbim të vendimmarrjeve të qeverisjes së përgjithshme, në nivele qendrore dhe lokale. Nisur nga fakti se Pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara kanë si qëllim të përgjithshëm dhënien e informacionit të besueshëm tek organet përkatëse vendimmarrëse, nëpërmjet: Sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimit të tyre; Sigurimit të informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave mbi mjetet monetare; Sigurimit të informacionit që lidhet me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet; si dhe Sigurimit të informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë raportuese.

Mos hartimi i pasqyrave financiare përmbledhëse të konsoliduara nuk mundëson grupimin e informacionit, duke bërë eliminimet dhe duke mënjeluar dublimet, për njësitë e organeve të vetëqeverisjes vendore, me të gjitha njësitë e varësisë; Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli IV “Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara” pika 98, 99,100,101 germa “b” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi: Bashkia Mat, Sektori i Financës, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për të hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara për të Bashkisë në vitet në vijim ku të evidentohen edhe pasqyrat financiare të 3 (tre) njësi vartëse e përkatësisht, Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Sportit, Ndërmarrja e Ujësjiellit sha.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE në vlerën prej 164,851,202 lekë.

1.Gjetje nga auditimi: Në realizimin e të ardhurave nga tarifat e Drejtorisë së shërbimeve bashkiake, sektori i infrastrukturës, Bashkia Mat, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën **5,000,000 lekë**, sipas aneksit nr.1, bashkangjitur, për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrjnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

nga konsumatorët fundorë. Gjithashtu nuk janë pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, të trajtuara në aneksin nr.1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kapitulli II, pika 1; germa “b”; pika 9 dhe të VKB nr.69, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e detyrime të pa arkëtuara nga licencat e subjekteve të tregimit të karburanteve në vlerën **5,000,000 lekë**, me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Mat, sipas aneksit nr.1, bashkangjitur.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Dibër. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Mat, konstatohet se deri më 31.12.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 83 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 22325,84 m², jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe -VKB nr.33, datë 08.01.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, ndryshuar me VKB nr.33, datë 23.05.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale 2018”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër, sipas aneksit nr.2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 2,853,017 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 17-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Sektori i Financës, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim me ALUIZNI dhe ZVRPP Mat, të merren masa për *kontabilizimin* e vlerës dhe zgjidhjen e situatës të krijuar duke ndjekur procedurat administrative-ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit në vlerën 2,853,017 lekë, sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSE.

Aneksi nr.1

Pasqyra e detyrimeve të subjekteve që tregojnë karburante pa pajisur me autorizime periudha 01.01.2018-30.12.2018.

Nr	Subjekti	Administratori	Adresa	Nipti	Vlera
1	P. O. shpk	A. P.	Fshati Burrel Nj. Adm Komsi	L.....G	1,000,000
2	C. 2010 Shpk	A. C.	Baz	L.....E	1,000,000
3	E.-2013 shpk	Xh. D.	Shoshaj	L.....R	1,000,000
4	D. O. shpk	B. C.	F. Burrel	L.....G	1,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në "Bashkinë Mat"

5	G. C. GKËG shpk	D. G.	Burrel	K.....T	1,000,000
	TOTALI				5,000,000

Aneksi nr.2

Pasqyra e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastructure nga Leje e Legalizimit.

NR. REND	EMËR ATËSI MBIEMËR	ADRESA E	SIP. TOT	SIP. TOT	SIP. TOT.	PA PAGUAR
		OBJEKTIT	NDËRT. M2	SOC. EKON	BANIM	
1	XH. A. V.	B.BURREL	92	0	92	20378
2	A. V. M.	F.KOMSI	138,3	0	138,3	30633,45
3	A. K. D.	B.BURREL	117,8	0	117,8	26092,7
4	F. H. B.	F.BURREL	233	0	233	51609,5
5	N. H. B.	F.BURREL	332	0	332	73538
6	SH. R. C.	F.MUZHAKË	387	0	387	85720,5
7	RR. S. RR.	F.MUZHAKË	88,8	0	88,8	19669,2
8	SH. R. C.	F.MUZHAKË	387	0	387	85720,5
9	B. H. P.	27360	115,3	0	115,3	25538,95
10	RR. S. RR.	F.MUZHAKË	88,8	0	88,8	19669,2
11	N. M. K.	B.BURREL	185,5	0	185,5	41088,25
12	F. R. N.	F.DERJAN	118	0	118	26137
13	Z. S. M.	F.KOMSI	143,8	0	143,8	31851,7
14	E. XH. GJ.	F.ULËZ	140	0	140	31010
15	E. R. H.	L. P.BUDI	108	0	108	23922
16	F. M. P.	F.BURREL	184,8	0	184,8	40933,2
17	N. L. L.	B.MAT	91,8	0	91,8	20333,7
18	S. N. R.	F.BUSHKASH	86,1	0	86,1	19071,15
19	D. P. LL.	F.BUSHKASH	77,8	0	77,8	17232,7
20	T. M. LL.	F.BUSHKASH	114	0	114	25251
21	F. LL. R.	F.BUSHKASH	402,3	0	402,3	89109,45
22	G. N. S.	F.BUSHKASH	64	0	64	14176
23	GJ. P. R.	F.BUSHKASH	376	0	376	83284
24	N. N. S.	F.BUSHKASH	217,2	0	217,2	48109,8
25	I. A. LL.	F.BURREL	118,7	118,7	0	26292,05
26	D. M. S.	F.BUSHKASH	125,4	0	125,4	27776,1
27	N. GJ. R.	F.BUSHKASH	150	0	150	33225
28	V. A. H.	L."P.BUDI"	75,2	75,2	0	16656,8
29	P. S. K.	L."P.BUDI"	24	24	0	5316
30	E. R. D.	L."DRITA"	157,9	0	157,9	34974,85
31	B. E. K.	L."DRITA"	338,8	0	338,8	75044,2
32	D. P. GJ.	NJ.A."ULËZ"	141	16,6	124,4	31231,5
33	XH. S. GJ.	F.BURREL	123	0	123	27244,5
34	M. S. B.	F.BURREL	139,2	0	139,2	30832,8
35	R. A. B.	F.BURREL	113,5	0	113,5	25140,25
36	I. F. K.	L.PARTIZANI	234	234	0	51831
37	B. T. H.	F.KOMSI	77,5	77,5	0	17166,25
38	B. A. L.	L."DRITA"	70,2	0	70,2	15549,3
39	D. S. GJ.	L."P.BUDI"	31,6	31,6	0	6999,4
40	A. H. S.	B.BURREL	107	107	9	23700,5
41	H. M. P.	F.KOMSI	106	0	106	23479
42	A. A. A.	F.ZENISHT	232	0	232	51388
43	B. A. L.	L."DRITA"	32,2	0	32,2	7132,3
44	V. M. A.	L."P.BUDI"	37,8	37,8	0	8372,7
45	M. M. H.	FSHATI BATËR	133,1	0	133,1	29481,65
46	A. T. L.	FSHATI MUZHAKË	123,4	0	123,4	27333,1
47	D. A. H.	FSHATI MUZHAKË	123,1	0	123,1	27266,65
48	S. E. H.	FSHATI MUZHAKË	127,6	0	127,6	28263,4
49	N. XH. H.	FSHATI MUZHAKË	110	0	110	24365
50	SH. S. B.	FSHATI MUZHAKË	105,3	0	105,3	23323,95
51	N. D. B.	FSHATI MUZHAKË	377,4	0	377,4	83594,1
52	XH. S. B.	FSHATI MUZHAKË	105,9	0	105,9	23456,85
53	L. B. B.	FSHATI BATËR	90,3	0	90,3	20001,45
54	I. O. K.	L.PARTIZANI	48,34	24,17	24,17	10707,31
55	O. L. C.	L."P.BUDI"	71	0	71	15726,5
56	A. R. K.	L."DRITA"	115,5	0	115,5	25583,25
57	A. N. S.	L.PARTIZANI	225	87,5	137,5	49837,5
58	D. I. M.	L."P.BUDI"	113,3	0	113,3	25095,95
59	I. A. M.	L."P.BUDI"	113,3	0	113,3	25095,95
60	H. R. S.	L."DRITA"	140	140	0	31010
61	V. S. K.		404,2	0	404,2	89530,3
62	K. R. D.	L."P.BUDI"	157	0	157	34775,5
63	A. SH. K.	L."DRITA"	44,9	0	44,9	9945,35



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

64	H. E. L.	FSHATI KUJTIM SUÇ	145,5	0	145,5	32228,25
65	A. M. P.	FSHATI BURREL	118,7	0	118,7	26292,05
66	S. D. H.	L. "P.BUDI"	109,6	0	109,6	24276,4
67	B. A. A.	FSHATI MUZHAKË	108,5	0	108,5	24032,75
68	XH. H. K.	FSHATI MUZHAKË	152,1	0	152,1	33690,15
69	B. I. L.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	87,2	0	87,2	19314,8
70	P. R. B.	FSHATI BURREL	155,1	0	155,1	34354,65
71	F. A. K.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	260	0	260	57590
72	A. H. T.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	241,8	0	241,8	53558,7
73	G. B. H.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	46,9	0	46,9	10388,35
74	A. I. K.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	617,4	0	617,4	136754,1
75	G. S. M.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	86,5	0	86,5	19159,75
76	R. B. B.	FSHATI BATËR E VOGËL	138,6	0	138,6	30699,9
77	A. S. S. + K. S.	FSHATI BURREL	120,5	0	120,5	26690,75
78	H. D. D.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	348,2	0	348,2	77126,3
79	D. R. S.	LAGJA: "DRITA"	315,8	0	315,8	69949,7
80	XH. H. B.	FSHATI MUZHAKË, KOMSI	285,1	0	285,1	63149,65
81	H. SH. B.			0		
82	X. I. H.	FSHATI BATËR E VOGËL	90	0	90	19935
83	T. I. H.			0		
	Totali		22325,84	3334,37	19242,27	2,853,017

Pasqyra e pozicionit Financiar Viti 2018, Bashkia Mat.

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi mbyllur	Ushtrimi paraardhes
1	A	A K T I V E T	2,062,440,776	2,594,786,970
2		I. Aktivët Afat shkurtër	326,609,768	291,075,290
3		1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	119,345,093	109,411,083
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke		
6	520	Disponibilitete në Thesar	119,345,093	109,411,083
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizgjone zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11		2. Gjendje Inventari qarkullues	51,218,350	52,686,074
12	31	Materiale	4,612,523	6,721,870
13	32	Inventar i imët	46,605,827	45,964,204
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbritura, ose pranë të treta		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizgjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3. Llogari të Arketushme	112,221,078	96,067,645
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	16,416,542	16,416,542
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

28	436	Sigurime Shëndetësore		
29	437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	47,702,992	41,896,192
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	48,101,544	37,754,911
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	43,825,247	32,910,488
37	409	Parapagime		5,700
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	43,825,247	32,904,788
42		II.Aktivet Afat gjata	1,735,831,008	2,303,711,680
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	26,701,445	26,701,445
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kërkime	26,701,445	26,701,445
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,709,129,563	2,276,519,235
48	210	Toka, T,roje, Terene	27,362,728	26,247,728
49	211	Pyje, Plantacione	10,550,203	10,550,203
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	803,622,686	789,221,788
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	828,258,727	1,403,434,550
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	5,951,211	7,698,963
53	215	Mjete Transporti	15,344,888	17,266,110
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	18,039,120	22,099,893
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	0	491,000
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	0	491,000
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	172,187,325	150,801,911
66		I.Pasivet Afat shkurtra	172,187,325	150,801,911
67		1. Llogari te Pagushme	172,187,325	150,801,911
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	11,421,208	9,845,161
69	42	Detyrime ndaj personelit	13,597,328	18,715,379
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	732,869	701,274
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	4,029,432	4,023,031
76	436	Sigurime Shendetsore	553,111	552,826
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

		ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	16,141,000	21,823,778
82	467	Kreditore te ndryshem	61,592,843	36,822,028
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	64,119,534	58,318,434
84	49	Shuma te parashikuara per xhvlresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provizjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,890,253,451	2,443,985,059
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,890,253,451	2,443,985,059
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,781,046,453	2,194,842,101
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	103,204,093	87,587,305
101	111	Rezerva	0	
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvlresime	0	
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	6,002,905	161,064,653
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	491,000
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	
107		Te Tjera	0	0
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,062,440,776	2,594,786,970

Pasqyra e debitorëve më 31.12.2018.

Nr	Emertimi	Biznes I vogel	Biznes I madh	Biznes Vip	Loje fati	Gjoha	Institucione	Tregu	Te tjera	Totali
1.0	Njesia Ad.Burrel	15,549,004	8,984,219	1,446,510	854,514	2,750,000	420,500	2,548,900	0	32,553,647
2.0	NJ A Koms	977,198	1,906,807						743,075	3,627,080
3.0	NJ A Lis	406,945	2,120,601						160,440	2,687,986
4.0	NJ A Rukaj	221,760	57,000						3,259,167	3,537,927
5.0	NJ A Ulez	425,282	1,546,070						941,756	2,913,108
6.0	NJ A Baz	76,782							384,415	461,197
7.0	NJ A Macukull	330,700	131,576						471,558	933,834
8.0	NJ A Derjan	102,280							885,933	988,213
		18,089,951	14,746,273	1,446,510	854,514	2,750,000	420,500	2,548,900	6,846,344	47,702,992

Llogaria 401-408 Furnitor e llogari të lidhura me to.

Nr	Objekti	Operatori Fitues	Nr Fatures	Dt. Fatures	shuma leke DEBI
1	Emergjence(Riparim makine FAJ)	S. S.	12	13.12.2018	163,000
2	Sherbim interneti	L. S.	146	26.12.2018	197,500
3	Sherbime publikimi (Media)	V. shpk	64	26.12.2018	328,000
4	Blerje pako viti I Ri	A. -79	126	24.12.2018	558,000
5	Shpenzime siguracioni	S.	1332662	28.12.2018	18,960
6	Tarifa permbarimore	Sh. A.	42	03.12.2018	1,971,483
7	Tarifa permbarimore	Sh. A.	45	03.12.2018	36,000
8	Sherbimi pastrimit	A. G.	65	03.12.2018	1,518,667



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

9	Pjese kembimi&riparime	K.	226168071	11.12.2018	167,436
10	Pjese kembimi&riparime	K.	226168072	11.12.2018	114,456
11	Pjese kembimi&riparime	K.	226168006	04.12.2018	98,400
12	Pjese kembimi&riparime	K.	226168073	11.12.2018	47,172
13	Pjese kembimi&riparime	K.	226168074	11.12.2018	33,888
14	Pjese kembimi&riparime	K.	226168075	11.12.2018	19,896
15	Pjese kembimi&riparime	K.	226168076	11.12.2018	38,796
16	ushqime	N. shpk	511	07.12.2018	208,260
17	ushqime	N. shpk	510	24.12.2018	504,121
18	Poster Adesiv	A. D.	52	13.12.2018	40,000
19	Sherbime postare dhjetor	P. M.	454	31.12.2018	29,000
20	Sherbime postare dhjetor	P. M.	484	31.12.2018	30,654
21	Sherbime postare dhjetor	P. M.	485	31.12.2018	36,950
22	Sherbime postare dhjetor	P. M.	486	31.12.2018	32,644
23	Sherbime postare dhjetor	P. M.	487	31.12.2018	19,969
24	Sherbime postare dhjetor	P. M.	488	31.12.2018	5,270
25	Sherbime postare dhjetor	P. M.	489	31.12.2018	37,357
26	Sherbime postare dhjetor	P. M.	490	31.12.2018	9,300
27	Sherbime postare dhjetor	P. M.	491	31.12.2018	21,006
28	Sherbime postare dhjetor	P. M.	492	31.12.2018	22,315
29	Sherbime postare dhjetor	P. M.	498	31.12.2018	135
30	Shp uji dhjetor	U.	460	31.12.2018	168,312
36	Mirembajtje kanale vaditese 2018	V. N. I. S	16	28.12.2018	1,130,124
37	kolaudim punimesh Shkolla 31 korriku	G& shpk	196	14.12.2018	83,097
38	Blerje pllaka per sheshin	K T.	209	03.12.2018	3,616,200
39	Blerje pajisje elektronike dhe elektrike	O. shpk	583	11.12.2018	114,840
	shuma 401				11,421,208

Përmbledhëse e faturave të pa likuajuara gjendje më 31.12.2018.

Llogari	Përshkrimi	2018
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	11,421,208.00
42	Detyrime ndaj personelit	13,597,328.00
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	732,869.00
435	Sigurime Shoqërore	4,029,432.00
436	Sigurime Shendetesore	553,111.00

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” viti 2018

Nr	Objekti	Operatori Fitues	Nr Fatures	Dt. Fatures	shuma leke DEBI
1	Mirembajtje Objekte ndertimore 2018	V. N. I S	50	05.10.2018	3,451,068
2	Sponsorizime Gazeta Mati	G. M.	VKB nr 93	01.11.2018	100,000
3	Trajtimi qenve endacake	T. K.	541	16.11.2018	491,760
4	Riparim guzhine Cerdhe nr 2	H. R.	318	21.11.2018	83,000
5	Shp per mirembajtje eskavatori	T& C SHPK	473	30.07.2018	104,905
6	Sherbimi pastrimit	A. G.	59	21.11.2018	1,833,761
7	Blerje libri	A. K.	29	26.08.2018	326,500
8	Qese te zeza dhe doreza	H. SHPK	3713	21.11.2018	18,000
9	Pjese kembimi&riparime	K.	226136373	20.11.2018	48,960
10	Pjese kembimi&riparime	K.	226136375	20.11.2018	33,840
11	Pjese kembimi&riparime	K.	226136376	20.11.2018	23,040
12	Pjese kembimi&riparime	K.	226136379	20.11.2018	15,120
13	Pjese kembimi&riparime	K.	226167865	20.11.2018	156,300
14	ushqime	N. SHPK	506	27.11.2018	352,362
15	ushqime	N. SHPK	507	27.11.2018	39,912
16	Blerje uniformash per pol bashkiake & zjarrfikesen	B. S.	827	27.11.2018	1,305,780
17	Shperblim keshilli tetor	Bordero date		12.11.2018	406,380
18	Paga Agj Bujqesise shtator	Bordero date		01.10.2018	396,269
19	Paga Agj Bujqesise tetor	Bordero date		01.11.2018	396,269
20	Paga Aparati diferenc tetor	Bordero date		02.11.2018	3,805,167
21	Ndihma financiare(Emergence)	H. D.	VKB nr 90	01.11.2018	50,000
22	Trajtim ushqimor Sporti	Bordero date		30.06.2011	631,800
23	Karburant	J. -06	04	30.11.2018	351,638



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin Financiar (Tematik) të ushtruar në “Bashkinë Mat”

24	Mbiqueq pun Rik rruge dhe trotuare	E. -G	58	07.11.2018	54,000
25	Punime rrugore Lagja Drita Faza II	E.	14	28.11.2018	2,499,916
26	Mbiqueq Rehab fasadash faza permbyltese	D. E	27	09.11.2019	118,200
27	Kancelari	I.	228948036	14.06.2018	1,054,231
29	Shp vendime gjyqesore	L. K.			672,086
30	Shp vendime gjyqesore	G. P.			1,929,864
31	Shp vendime gjyqesore	B. SHPK			13,441,516
32	Rik kanali Derjan	V. N. I S	40	01.12.2017	4,209,369
33	Mirembajtje kanale vaditese	V. N. I S	88	18.08.2017	1,214,964
34	Rik shkolla 31 korriku V NDERTIM IS	V. N. I S		27.12.2018	4,209,270
	SHUMA				43,825,247